


**ANALIZË E PËRMBAJTJES DHE E ZBATIMIT PRAKTIK  
TË LIGJIT PËR AGJENCINË E SIGURISË KOMBËTARE DHE  
LIGJIT PËR KOORDINIMIN E BASHKËSISË TË SIGURISË  
DHE ZBULIMIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT**



Prof. Dr. Zllate Dimovski

Shkup, shkurt 2021



### **Për këtë analizë**

Kjo analizë është përgatitur si pjesë e programit të DCAF për reforma në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut.

Pikëpamjet e shprehura janë vetëm të autorit dhe nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e institucioneve të referuara apo të përfaqësuara në kuadër të këtij publikimi.

### **Shënim**

Përmbajtja e këtij publikimi mund të citohet vetëm pas pajtimit me shkrim nga DCAF, dhe me njohjen e burimit.

### **Për DCAF**

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë është një fondacion ndërkombëtar misioni i të cilës është që të ndihmojë komunitetin ndërkombëtar në ndjekjen e reformës të qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë. DCAF harton dhe promovon norma dhe standarde, realizon hulumtime të përshtatura të politikave, identifikon praktika dhe rekomandime të mira për të promovuar qeverisje demokratike në sektorin e sigurisë, dhe ofron mbështetje këshillëdhënëse brenda vendit dhe programe të ndihmës praktike.

© 2021 DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë

## REZYME EKZEKUTIVE

Duke u mbështetur në përvojat e së kaluarës, RMV bën përpjekje për të ndërtuar një sistem sigurie, i cili do të jetë në funksion të mbrojtjes (të paraparë me kushtetutë) të sistemit shoqëror dhe qytetarëve të këtij shteti. Në kontekst të funksionimit të shërbimeve, të cilat ishin në kuadër të sistemit të sigurisë gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të Maqedonisë jashtë Federatës Jugosllave dhe ndërtimit të së ashtuquajturit sistem demokratik, shërbimet treguan se nuk përshtaten mjaftueshëm në trendet e reja shoqërore shkaku i dëshirës që gjithmonë të dominojnë, duke pasur në dispozicion informacione të llojllojshme (politike, ekonomike, demografike, sociale), e më së paku informacione sigurie. Prirjet e këtyra ishin në funksion të strukturave në pushtet, të cilat duke zbatuar metoda dhe mjete nga infrastruktura publike dhe sekrete, synonin të jenë në rrjedha me të gjitha zhvillimet në vend, e sidomos me aktivitetet e kundërshtarëve politikë. U bë e zakonshme që formacionet politike të keqpërdorin kapacitetet e sigurisë dhe zbulimit, ndërsa pala tjetër, duke qenë në dijeni për këto keqpërdorime, dekonspiroi një pjesë të tyre sipas nevojave të veta politike. Kjo krijoi neveri dhe një opinion negativ për shërbimet e kësaj sfere, si dhe u fitua përshtypja se ekziston “polici politike”. Tendencat për të inkuadruar RMV në rrjedhat bashkëkohore, të imponuara nga kriteriumet për anëtarësi në NATO dhe BE, inicuan skenim të gjendjes në komunitetin e sigurisë dhe kundërzbulimit, e nga më shumë raporte dhe vlerësues të jashtëm u konstatua se ajo është vërtetë dëshpëruese. Të gjitha këto raporte flasin për keqpërdorime të vazhdueshme dhe rrezikim të të drejtave dhe lirive të njeriut, po ashtu dhe për funksionim të shërbimeve jashtë misionit dhe vizionit të tyre, si dhe jashtë kompetencave ligjore, gjithmonë duke u fshehur nën pretekstin e “fshehtësisë së aktiviteteve”. U vlerësua se gjendja nuk është e qëndrueshme dhe rrjedhimisht u paraqiti nevoja për reforma të komunitetit të sigurisë dhe zbulimit në RMV.

Pritshmëritë ishin se qasja do të ishte shumë më e ndërgjegjshme, më konkrete dhe më profesionale drejt koncipimit të kornizës ligjore të shërbimeve dhe harmonizimit të misionit, kompetencave dhe qëllimit të funksionimit të të gjitha shërbimeve që, sipas natyrës së veprimtarisë për të cilën janë formuar, i përkasin komunitetit të sigurisë. Mirëpo, ndodhi e kundërta dhe u soll vendim politik për reformim të vetëm një shërbimi, ish-DSK në ASK, dhe me disa të ashtuquajtura intervenime kozmetike qëllimi ishte të fitohej përshtypje se reforma po ndodh dhe shërbimi i ri të fillojë të funksionojë. Sinjalet politike preferonin kopjim të modelit kroat për shërbime të reformuara. U anashkaluan disa elemente të shërbimit të atjeshëm: përvoja, njohuritë, bashkëpunimi me shërbime tjera dhe ndërtimi i një modeli vetanak, rrethanat gjeostrategjike, gjendja e brendshme, mentaliteti i qytetarëve, niveli i zbatimit të demokracisë dhe rrethanat e përgjithshme në të kaluarën. Propozim-ligji inicial, i bazuar në elementet e lartpërmendura, i kaloi të gjitha fazat dhe pësoi disa ndryshime, ku propozuesi mori parasysh rekomandimet/ dhe vërejtjet e ekspertëve, si dhe pikëpamje politike dhe udhëzime të dhëna nga shtetet mike të BE-së. Në tekstin final sërish u vërejtën shumë lëshime në kontekst të harmonizimit me Kushtetutën e RMV-së dhe ligjeve tjera, të cilat definojnë sfera që ndeshen me projektet e propozuara ligjore.

Problemi më i ndjeshëm e që ngjalli më së shumti interes gjatë periudhës së kaluar, ishte mundësia që DSK të përdorë metoda dhe mjete të fshehta, sidomos metoda dhe mjete të veçanta hetuesie (me miratim të Drejtorit, gjë që nuk është e mundur!), përfshi këtu edhe kontrollin sekret të komunikimeve, që njihet edhe

si “përgjim”. Nga strukturat politike kishte informacione se numri i personave të përgjuar ishte shumë i madh, e si provë për një aktivitet të tillë u publikuan dhe ende publikohen biseda “të përgjuara”, të cilat përdoren edhe si mjet për “luftë politike”. Gjendja e këtillë imponoi nevojën për themelimin e AOT, përkufizim të rreptë të mundësisë për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve dhe definimin e procedurave për miratim, ushtrim të masës, eksploatim të rezultateve, përdorim dhe kontroll mbi aktivitetet e përgjithshme. Propozim-ligji inicial për ASK nuk parashihte mundësi për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve pa ndërmjetësim të AOT, por më vonë, me miratimin e ligjit, Agjencisë iu dha mundësi juridike që në raste konkrete të zbatojë masa të tilla, me mjete të veçanta që ka në dispozicion dhe me obligimin që ai proces të jetë transparent në kuptim të krijimit të mundësive dhe autorizimit të atyre subjekteve që do të kryejnë kontroll dhe mbikëqyrje të këtyre masave. Mirëpo, nuk u përfshi kontrolli lidhur me pronësinë e rezultateve nga masa e ndërmarrë dhe mundësitë për ndryshim, plotësim, falsifikim etj., të transkriptave të siguruar nga zbatimi i masës.

Në kuadër të Ligjit për ASK, si organe kontrolli dhe mbikëqyrjeje, janë paraparë disa njësi dhe institucione nga lëmi të ndryshme. Në kuadër të Kuvendit të RMV-së, konform Rregullores, formohen dy komisione që kanë kompetenca për kryerje kontrolli mbi punën e ASK-së. Mirëpo, ligjvënësi në kornizën ligjore për ASK parasheh dispozita që paraqesin shkelje të Kushtetutës së RMV-së, sepse kufizon kompetencat dhe rrezon e fushëveprimin për kontroll të mundshëm.

Këto komisione nga Drejtori i ASK-së mund të kërkojnë raporte, analiza dhe brifingje për punën e ASK-së, lidhur me gjendje apo aktivitete të caktuara. Edhe pse ekziston përshtypja se komisionet me punën e tyre mund të kontribuojnë shumë në funksionimin ligjor dhe transparent të ASK-së, prapëseprapë ato nuk dhanë rezultatet e pritura. Para reformimit të DSK-së, drejtori vendoste kokë më vete që të mos shkojë në takimet e parapara me anëtarët e komisioneve dhe me këtë demonstrim fuqie, arrogance dhe padëgjueshmërie, fitohej përshtypja se Qeveria kontrollon Kuvendin, e jo e kundërta, siç e përcakton norma pozitive ligjore. Sjellja e tillë ishte rezultat i mosekzistimit të instrumenteve për konstatim të përgjegjësisë së personit përkatës dhe mundësisë që të paktën të inicohet procedurë për shkarkimin e tij. Edhe pse me ligjin e ri u bënë përpjekje për të ngritur nivelin e përgjegjësisë së drejtorit të ASK-së, si dhe të kufizohen kompetencat e tij/saj, prapëseprapë kjo nuk është e mjaftueshme. Drejtori sërish ka kompetenca të gjëra: miraton aktet nënligjore të ASK-së së sapoformuar, delegon kompetencat dhe miraton ushtrimin e veprimeve të caktuara sekrete, e madje ka të drejtën diskrete të autorizojë veten që të vendosë për punësime në ASK, pa shpallje publike. Në rrethana praktikimi demokracie siç është rasti me RMV-në, ku partitë bëjnë përpjekje të infiltrojnë sa më shumë simpatizantë të tyre në të gjitha porët e jetës shoqërore, e sidomos në shërbimet nga sfera e sigurisë, dhënia e një mundësie të tillë një personi është e panevojshme.

Në pritje të fuqizimit të mekanizmave për mbikëqyrje dhe kontroll të komunitetit për siguri, sërish janë paraparë organe dhe institucione si edhe më parë. Duke marrë parasysh përvojat negative nga aktiviteti i tyre, fitohet përshtypja se edhe me ligjin e ri duan të përfshihet aspekti i kontrollit dhe mbikëqyrjes, por kjo të mos funksionojë në praktikë. Në këtë drejtim kam konstatuar lëshime të shumta, paqartësi, përmbajtje që përsëriten në ligje të tjera dhe kontradikta me dispozitat kushtetuese. Për shembull, organet e kontrollit siç është Prokuroria Publike dhe Gjykata Supreme, në punën e përditshme që bëjnë, janë të kufizuara vetëm në kontroll të masave të cilat kanë lejuar të ndërmerren. Avokati i Popullit, Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara, Agjencia për Mbrojtje të të Dhënave

Personale si dhe Enti Shtetëror për Revizion, janë organe që kryejnë mbikëqyrje mbi pronësinë, përdorimin dhe shkeljen të vetëm disa segmenteve nga puna e ASK-së. Në pajtim me Ligjin për ndjekje të komunikimeve, në formim e sipër është edhe Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare, i cili ka kompetenca të caktuara, por nuk disponon me asnjë lloj instrumenti me të cilin do të konstatoheshin dhe procedoheshin veprime joligjore. Në kuadër të ASK-së si njësi organizative u themelua Sektori për Kontroll të Brendshëm, por me ingerenca të paqarta dhe të kufizuara për kontroll, e me panjohuri edhe më të mëdha në raport me ushtrimin e masave për të konstatuar, për të siguruar prova dhe për të paraqitur parashtrësia të caktuara institucioneve përkatëse, ndërsa kompetencat më të pakta i ka në raport me ekipin udhëheqës (drejtor, zëvendësdrejtor).

Nëse secili organ do të kishte kryer detyrën ligjore ashtu siç duhet, struktura e tillë do të premtonte një shkallë të volitshme kontrolli dhe mbikëqyrjeje. Duke e pasur parasysh se ndikimet “politike” kanë ende peshë, kemi arsye që të dyshojmë se kontrolli dhe mbikëqyrja të vendosura në këtë mënyrë nuk do të japin rezultatet e dëshiruara. Prandaj, them se korniza ligjore është e mjaftueshme, me korrigjime të disa paqartësive, por mungon shkalla e implementimit të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe zbatim i teorisë në praktikë. Organet e deklaruara jopartiake në fakt janë fshehurazi partiake, e kjo më së shumti është rezultat i tendencës së partisë në pushtet që të ushtrojë ndikim në të gjitha segmentet e jetës shoqërore. Për këtë arsye edhe ligjet gjithmonë kanë paqartësi, zbrazëtira ligjore, me qëllim që të shmanget intervenimi legjitim. Është e nevojshme që t’i kushtohet vëmendje më e madhe ngritjes së ndërgjegjshmërisë dhe ndërtimit të kapaciteteve për vetëdijesim lidhur me veprimet e këtyra që copëtojnë organizmin shtetëror, krijojnë parakushte për forma më të rënda të shkeljes së ligjeve, krijojnë institucione jofunksionale, nxisin sjellje klienteliste, korrupsion dhe fenomene tjera negative shoqërore, të cilat në periudhë afatgjate do ta ngarkojnë shtetin dhe do të pamundësojnë zhvillimin e marrëdhënieve bashkëkohore.

Gjendja me burimet njerëzore po ashtu kërkon vëmendje. Konkretisht, transferimi i të punësuarve nga DSK në ASN u përcoll nga disa anomali: kritere të paqarta, vlerësim i padrejtë, ndikime partiake dhe ngjashëm. Po ashtu me ligj nuk është përcaktuar qartë dhe në mënyrë decide procedura për avancim dhe ndërtim karriere, trajnimet, përvojat dhe njohuritë e duhura, si dhe arritja e rezultateve pozitive në punë, për të rrumbullakuar procesin e vlerësimit. Nuk ekzistojnë kritere objektive për vlerësim të arritjeve, nuk ka cikël avancimi, nuk ka mekanizma që do ta kishin kufizuar “arbitraritetin” e ekipit udhëheqës në raport me evaluimin e rezultateve të të punësuarve dhe emërimin në funksione më të larta. Gjendja e këtillë duhet të ndryshohet, që të mund të krijohet ambient i sigurt dhe të punësuarit të mund t’u përkushtohen detyrave që kanë.

Me themelimin e Këshillit për Koordinim të Komunitetit të Sigurisë dhe Zbulimit përshtypja e përgjithshme është se sikur u arrit qëllimi i elitave politiko-partiake për të dominuar me shërbimet dhe për mundësinë e grumbullimit, analizës dhe shpërndarjes së informacioneve dhe produkteve të zbulimit për qëllimet dhe nevojat e tyre. Për këtë arsye, në analizë janë dhënë më shumë vërejtje dhe rekomandime për tejkalim të kësaj gjendjeje.

Reathanat e paraqitura tregojnë ambientin real dhe përmes analizës së zgjidhjeve ligjore fitohet një pasqyrë e përgjithshme për gjendjen e vërtetë, dhe kur gjithë kësaj ia shtojmë edhe zbatimin jopërkates të kornizës juridike, kuptojmë domosdoshmërinë për balancim të pritshmërive dhe nevojave. Këto përshtypje të sublimuara dhe gjendja e konstatuar, përfshihen në analizën e bërë të ligjeve.

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE</b> .....	<b>9</b>
Arsyet për gjendjen aktuale.....	11
Hapat reformues.....	11
Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare.....	13
Ligji për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit të RMV.....	26
<b>KONKLUZA DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>29</b>
<b>LIGJE TË PËRDORURA</b> .....	<b>30</b>

## HYRJE

Sektori i sigurisë dhe zbulimit në Republikën e Maqedonisë Veriore ekziston që nga koha kur ajo ishte njësi federale në ish-RSFJ. Kuptohet që brenda kësaj njësie ekzistonte një sistem i centralizuar në nivelin e të gjithë vendit. Më vonë, pas pavarësimit, ishte e nevojshme të ndryshohen elemente të caktuara në mënyrë që të bëhen ndryshime specifike në sistemin e sigurisë dhe zbulimit, me qëllim që të prezantohet një drejtim i ri dhe i duhur, që nuk do të njihej dhe ndiqej nga ish-shërbimet partnere brenda RSFJ-së. Kështu, në vitin 1991, u imponua nevoja për të ashtuquajturin **modernizim të Shërbimit të Sigurimit të Shtetit-ShSSH** dhe me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Punë të Brendshme të vitit 1980 (Gazeta Zyrtare e RSM-së, nr. 36/91) më 6 gusht 1991 “Sekretariati i Punëve të Brendshme të RSM” u riemërua në “Ministri e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë” dhe në kuadër të Ministrisë, punët e sigurimit vazhduan të jenë nën ingerencat operative të Shërbimit të Sigurimit të Shtetit.

Si një shtesë dhe pjesë e veçantë, më 1992 u krijua **Sektori - Shërbimi i Sigurisë Ushtarake dhe Zbulimit-SShSUZ**, si vazhdimësi e KOS (shërbimi për kundërzbulim i armatës së RSFJ-së), i themeluar pas pavarësimit me një akt sistematizimi të Ministrisë së Mbrojtjes, pas transformimit të Sekretariatit Republikan për Mbrojtje Popullore të RS të Maqedonisë në Ministri të Mbrojtjes. Ky sektor ekziston edhe sot dhe është përgjegjës për aspektet mbrojtëse të zbulimit dhe kundërzbulimit të sektorit ushtarak dhe anëtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes së RMV.

**Shërbimi i Sigurimit të Shtetit-ShSSH** pushoi së ekzistuari me miratimin e Ligjit të ri për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19/95) nga 06.04.1995, me çka kompetencat e ShSSH iu transferuan **Departamentit për Siguri dhe Kundërzbulim-DSK**, si pjesë integrale e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Të gjithë sektorët përveç Sektorit 1 të ShSSH u transferuan në DSK. Nga ai sektor, u formua **Agjencia e Zbulimit**, e themeluar si një organ i pavarur i administratës shtetërore me Ligjin për Agjencinë e Zbulimit (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 19/95) datë 06.04.1995. Për punën e tij dhe punën e Agjencisë, drejtori i përgjigjet Kryetarit të Republikës së Maqedonisë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e Agjencisë mund të kërkojë përgjegjësi nga Drejtori.

Sipas nenit 65 paragrafit 1 pikës 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2000) të datës 21.07.2000, **Departamenti për Siguri dhe Kundërzbulim vazhdon të funksionojë si Drejtori për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), si organ brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.**

Me Ligjin për Agjencinë Operative-Teknike (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71/18) nga data 19.04.2018, më 01.11.2018 filloi me punë **Agjencia Operative-Teknike (AOT)**, që përgjigjet para Parlamentit të RMV-së dhe Qeverisë.

Para një viti, me Ligjin për Agjencinë Kombëtare të Sigurisë (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 108), të 28 majit 2019, u themelua pasardhësi i DSK, **Agjencia e Sigurisë Kombëtare (ASK)**, dhe filloi të funksionojë nga 1 shtatori 2019.

Me Ligjin për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit në RMV (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 108) gjithashtu nga 28 maji 2019, u themelua **Këshilli për Koordinimin e Bashkësisë të Sigurisë dhe Zbulimit në RMV**, i cili poashtu filloi të funksionojë më datë 01.09.2019.

Gjatë ekzistimit si DSK (emërtimi i fundit para reformimit në ASK), këtë shërbim e ndoqën afera të ndryshme. Akuzat gjithmonë vinin nga partitë opozitare, të cilat vazhdimisht akuzonin se monitorohen (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përgjimit të komunikimeve dhe burimeve tjera teknike e operative), të pasuara nga skandalet “Zogu i kaltër”, “Veshi i madh”, “Regjistrimi”, “Vjedhja e arkivit digjital të DSK-së”, “Bombat” dhe të tjera. Ngjarjet e këtilla çuan në çorganizim dhe devalvim të rolit të DSK-së.

Veprimet për dekonspirimin e punës së DSK-së ishin gjithashtu të rëndësishme. Hapi i parë u bë në vitin 2000 kur u bë Deklasifikimi i dosjeve për personat e evidentuar nga Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, përmes Ligjit për trajtimin e dosjeve për personat e evidentuar nga Shërbimi i Sigurimit të Shtetit (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/2000) nga data 05.07.2000. Me këtë ligj përcaktohet procedura e informimit dhe përdorimit të dosjeve personale, të mbajtura nga ish-Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, përkatësisht Departamentit për Siguri dhe Kundërzbulim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën nga viti 1945 deri në ditën e përcaktuar me ligj (13.07.2000), respektivisht deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji përcaktoi procedurën e ruajtjes, përdorimit dhe asgjësimit të tyre të mëtutjeshëm, si dhe kontrollin mbi ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra. Në atë kohë, një numër i madh i personave që kishin informacione se DSK i ka në evidencë, kërkuan që dosjet e tyre të hapeshin. Për më tepër, ata që parashtuan kërkesa të tilla, patën mundësinë të kërkojnë mikrofilmim të materialeve dhe t'u dorëzohen përmbajtjet e të gjitha dosjeve, madje edhe atyre që ende ishin nën trajtim operacional nga shërbimi.

Hapi i dytë ishte në vitin 2012, kur u miratua një ligj plotësisht i ri për lustrim, për të zëvendësuar ligjin e vitit 2008. Ligji nga viti 2012, emri zyrtar i të cilit ishte Ligji për përcaktimin e kushtit shtesë për ushtrimin e funksionit publik, sollti më shumë risi në krahasim me ligjin paraprak, siç janë: publikim i listës së personave të lustruar; riafatizim i procesit të lustrimit deri në vitin 2006; mundësi që burim informacioni për lustrim të jenë jo vetëm organet shtetërore, por edhe personat fizikë dhe juridikë, etj. Ky ligj zgjeron gjithashtu përkufizimin e bashkëpunimit me policinë sekrete. Për dallim nga ligji i vitit 2008, i cili përcaktonte bashkëpunimin si “bashkëpunim dhe veprimtari të fshehtë, të vetëdijshme, të vazhdueshme dhe të organizuar, e bazuar në dokument me shkrim me organet e sigurimit të shtetit”, në ligjin e vitit 2012 Komisioni për Verifikimin e Fakteve (si organ kompetent për lustrim) kishte autorizim të lustrojë një person të evidentuar në dosjet e organeve të sigurimit të shtetit si “bashkëpunëtor sekret, ndërlidhës operacional ose informator sekret” gjatë grumbullimit, raportimit dhe sigurimit të të dhënave operative që kanë qenë objekt përpunimi, ruajtjeje dhe përdorimi nga autoritetet e sigurimit shtetëror. Nën pretekstin e pastrimit të pretenduar të mbetjeve të së kaluarës dhe lustrimit të personave që përmes bashkëpunimit me DSK kanë pasur përfitime të caktuara, lustrimi u përqendrua në disa prej punëtorëve operacionalë dhe në figura të caktuara publike për denigrimin e tyre. Rezultatet ishin dëshpëruese për besimin ndaj DSK-së.

Në vitin 2015, në përputhje me Raportin e Pribes, si pjesë e zgjidhjes së krizës politike në Maqedoni, procesi i lustrimit u ndalua dhe Komisioni për Verifikimin e Fakteve vazhdoi të punojë deri në përfundimin e proceseve gjyqësore që kishin filluar për disa nga personat e lustruar. Deri në atë kohë në Maqedoni ishin lustruar 300 persona, edhe pse Komisioni për Verifikimin e Fakteve kishte kontrolluar 30.000 të tillë.



Këta dy hapa themelorë çuan në çorganizim, komprometim, mosbesim dhe etiketim të DSK-së si institucion të pandershëm, politik, klientelist dhe joefikas. Për shkak të gjithë këtyre zhvillimeve, me theks të veçantë në aferën e fundit “Bombat” dhe në përputhje me mendimin e paraqitur (në vitin 2015) në raportin e ekspertit gjerman të BE-së Reinhard Pribe, të bërë pas skandalit të përgjimeve masive, u potencua domosdoshmëria për reforma në gjithë sistemin e sigurisë dhe zbulimit shtetëror. Kjo reformë u mbështet nga BE dhe SHBA dhe u dha propozimi për projekt reformues të sistemit të sigurisë dhe zbulimit në RM, pas së cilës u miratuan dy tekstet ligjore që do të jenë objekt analize në këtë raport.

## **Arsyet për gjendjen aktuale**

Arsyet për reforma në Republikën e Maqedonisë së Veriut qëndrojnë në konstatimet se ka një përqendrim pushteti në shërbimin e sigurisë shtetërore (DSK) dhe keqpërdorim të mekanizmit të mbikëqyrjes mbi të. Ky shërbim funksiononte jashtë kompetencave të tij ligjore, në emër të qeverisë, për të kontrolluar zyrtarë të nivelit të lartë në administratën publike, në prokurori, gjykatës dhe kundërshtarë politikë, e si rezultat i kësaj rrezikohej pavarësia e gjyqësorit dhe institucioneve tjera shtetërore, që krijonte përshtypjen se të gjitha institucionet janë të dirigjuara në kryerjen e veprimtarisë së tyre, jo në bazë të legjislacionit pozitiv, por të udhëhequra nga një qendër politike për interesat e tyre të ngushta partiake dhe personale.

Për sa i përket pajisjeve teknike, DSK kishte monopol në përdorimin e pajisjeve të mbikëqyrjes për aktivitete zbulimi dhe për hetimet penale. Në gjithë shtetin, ekskluzivitetin për monitorim dhe mbikëqyrje në emër të policisë, Drejtorisë së Doganave dhe Policisë Financiare, si dhe në emër të vet, e kishte DSK. Prandaj ajo, duke përdorur rezultatet e përdorimit të infrastrukturës sekrete operative, kishte njohuritë e duhura dhe përmes mjeteve e metodave të ndryshme të ndërhyrjes në hetimet penale, në mënyrë indirekte nënvlerësoi/minoi pavarësinë e kreut të hetimit (prokurorit). Duke vepruar në përputhje me nenet 175 dhe 176 të Ligjit për komunikime elektronike, secili nga tre operatorët kombëtarë të telekomunikacionit furnizoi DSK-në me pajisjet e nevojshme teknike, duke i mundësuar që në mënyrë të drejtpërdrejt të monitorojë qendrat e tyre operative. DSK mund të ndiqte komunikimet drejtpërdrejt, në mënyrë të pavarur dhe të lirë, pavarësisht nëse kishte apo jo urdhëresë gjyqësore në përputhje me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve. Skandali i përgjimeve masovike, i cili është akoma aktual, tregon mosrespektim të etikës profesionale, parimeve themelore të menaxhimit të rreziqeve dhe mungesë njohurish për ndjeshmërinë e detyrave të zbulimit brenda DSK-së. Gjithashtu shqetësuese është mungesa e dukshme e një shërbimi të trajnuar për të drejtat themelore dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Lidhjet familjare midis politikanëve të lartë dhe zyrtarëve të nivelit të lartë në DSK, si dhe në Prokurorinë Publike, gjithashtu krijuan një mjedis të rrezikshëm për konflikt interesash.

## **Hapat reformues**

Në qershor të vitit 2018, Këshilli i BE-së miratoi konkluzë për Republikën e Maqedonisë lidhur me perspektivën evropiane të vendit. Ato u konfirmuan më vonë nga Këshilli Evropian më 28 qershor 2018, duke theksuar rëndësinë për vazhdim të avancimit në zbatimin e Prioriteteve Urgjente për Reforma dhe realizimin e rezultateve të qëndrueshme në katër fusha kryesore të reformës.

Kjo përfshin sundimin e ligjit, si dhe reformën e shërbimeve të sigurisë dhe kundërzbulimit.

Suksesi i vendit në realizimin e këtyre prioritetëve do të ketë ndikim edhe në vendimin për caktimin e një date për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Prandaj, arritja e rezultateve konkrete në reformimin e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit është një nga prioritetet e përfshira në Listën e Prioritetëve që dorëzoi Komisioni Evropian dhe që duhej të zbatohet deri në qershor të vitit 2019.

Për të funksionalizuar prioritetet e përmendura, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendosi reformën e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit lart në agjendën e Planit Reformues.

Reforma e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit synon krijimin e një institucioni të reformuar, profesional, të pavarur dhe llogaridhënës, i cili do të veprojë në përputhje me normat e sapopërcaktuara ligjore që janë tepër strikte, konform standardeve të larta etike dhe profesionale, në mënyrë që të përmbushë Rekomandimet e Pribes.

Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare ishte një nga ligjet e propozuara për të reformuar shërbimet e sigurisë dhe zbulimit.

Për të siguruar një shkallë të lartë efikasiteti dhe funksionimi të suksesshëm të shërbimeve të sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe vendosjen e një mekanizmi të duhur për koordinimin e tyre në përputhje me standardet që janë të domosdoshme në avancimin e sistemeve të sigurisë dhe zbulimit të vendeve bashkëkohore evropiane, Qeveria e Maqedonisë së Veriut, në Seancën e 104-t të mbajtur më 20.11.2019, miratoi projekt-modelin për reformimin e sistemit të sigurisë dhe zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Planin për vënien në funksion të këtij modeli.

Thelbi i modelit të miratuar konsiston në ndarjen e Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht formimin e një organi të ri të pavarur të administratës shtetërore që do të mbulojë sigurinë e brendshme të shtetit dhe kryerjen e veprimtarive të kundërzbulimit, në mënyrë që të krijojë një institucion të reformuar, profesional, të pavarur dhe të përgjegjshëm. Krijimi i një organi të ri sovran dhe të pavarur, nënkupton miratimin e një ligji të veçantë i cili rregullon kompetencën, menaxhimin, organizimin, financimin dhe kontrollin e tij. Objekt veprimtarie do të jetë mbrojtja e sigurisë kombëtare të shtetit, pra pavarësia, sovraniteti, rendi kushtetues, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe çështje të tjera lidhur me sigurinë kombëtare.

Në të njëjtën kohë, modeli për reformimin e sistemit të sigurisë dhe kundërzbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut imponon nevojën për krijimin e një koordinimi adekuat të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit në vend, përmes zgjidhjeve të duhura ligjore, të cilat do të përcaktojnë mekanizmin, zbatimin i të cilit do të mundësojë tejkalimin e dobësive dhe mospërputhshmërive të detektuara si një problem thelbësor në funksionimin aktual të shërbimeve të sigurimit dhe kundërzbulimit. Për këtë qëllim, është miratuar një Ligj i veçantë për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të të cilit është përcaktuar qëllimi i koordinimit, themelimi i një organi të veçantë për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit, me definim të saktë të fushëveprimit, përbërjen, mënyrën e punës dhe vendimmarrjen, si dhe

aspektet specifike në lidhje me punën e tij, të cilat janë parashikuar me qëllim të implementimit të koordinimit efektiv të bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit – nga njëra anë, dhe detyrimet që ka bashkësia e sigurisë dhe zbulimit ndaj organit të lartpërmendur, nga ana tjetër.

## **Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare**

Ligji i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Sigurisë është një dokument i cili që nga momenti i miratimit të propozim-ligjit në Kuvend, pësoi ndryshime të caktuara, të cilat i vlerësoj si ngritje cilësore dhe potencim të parimeve të ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, efektivitetit, efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes. Kjo qasje duhet të çmohet, por praktika tregon se që nga momenti i miratimit të ligjit dhe procedurave, e deri në fillimin e punës së ASK-së, dhe madje edhe tani kur ajo tashmë funksionon, ka një dozë të theksuar të zbatimit të pasaktë, të shtrembëruar dhe të pamjaftueshëm profesional të kushteve, mënyrave, mjeteve dhe procedurave në funksionimin e këtij organi.

Për sqarim, do të paraqes vërejtjet e mia në tekstin ligjor dhe njëkohësisht do të shpjegoj lëshimet që janë bërë, që në fund të ofroj disa rekomandime për zgjidhje, të cilat në përbërjen e ardhshme parlamentare duhet të inkorporohen ose të udhëzohet ASK që përmes komisioneve për mbikëqyrje dhe kontroll, të korrigjojë lëshimet e bëra.

Në nenin 2 paraqiten arsyet, nevoja dhe qëllimi i krijimit të ASK-së, si dhe përcaktohen vlera dhe të drejta të caktuara, të parapara me Kushtetutën e RMV-së dhe në përputhje me dokumentet e ratifikuara ndërkombëtare. Konsideroj se radhitja e vlerave dhe të drejtave individuale mund të përmblihet në një shprehje “për mbrojtjen e vlerave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare”. Ky term do të shmangë numërimin dhe rrezikun që ndonjë vlerë apo e drejtë të mos përmendet ose të mos pranohet, nëse konstatohet në periudhën që vijon.

Në nenin 3, paragrafi 2 duhet të shlyhet. Ligjshmëria e veprimit nuk ka asnjë lidhje me partitë politike. Kjo pikë përmendet mjaftueshëm në vazhdimin e tekstit të ligjit. Ky formulim nuk çon në depolitizim dhe departizim të Agjencisë, por më shumë ngjan si një përcaktim deklarativ.

Neni 4 rendit kompetencat dhe individë ose grupe të veprave penale. Veprat e tjera penale nga Kapitulli 28 – *Krime kundër shtetit* nuk përmenden, e për të cilat Agjencia duhet të ketë jurisdiksion. Gjithashtu nuk përmenden sulmet që Agjencia duhet të hetojë, e të cilat janë të natyrës informatike dhe tekniko-teknologjike, si një formë bashkëkohore e kërcënimit. Nuk përmenden as fenomene të të ashtuquajturave sulme hibride, të cilat janë mjaft aktuale tani dhe do të vazhdojnë të jenë në të ardhmen. Mospërcaktimi i kompetencave mund të jetë pengesë për hetimin e mëtutjeshëm të formave të ndryshme të krimit dhe sulmeve ndaj sigurisë shtetërore. Propozoj plotësim të nenit, sepse në të ardhmen ligjshmëria e veprimit do të kontestohej përsëri.

Neni 6 është jo i plotë, i paqartë dhe nuk përputhet me Ligjin për procedure penale. Si një institucion që ka autorizim për të grumbulluar, përpunuar, shkëmbyer dhe mbrojtur informacione nga kompetenca e sigurisë kombëtare, kur edhe punonjësit e saj janë persona me autorizime, madje disa prej tyre me autorizime policore, nuk mjafton të parashihet vetëm informimi i Prokurorit Publik, sepse Prokuroria nuk ka instrumente dhe burime të veçanta për hetim

pa ndërmjetësimin e të gjitha shërbimeve të bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave. Nëse Agjencia ka informacione dhe të dhëna të tilla, në koordinim të ngushtë me shërbimet dhe organet e tjera të përmendura, ajo mund të veprojë shpejt dhe të arrijë një efektivitet dhe efikasitet të madh. Kjo është arsyeja pse propozoj plotësimin e nenit me shprehjen “shkëmbim informacionesh me shërbimet e tjera të zbatimit të ligjit, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore”.

Neni 7 është i paqartë dhe konfuz. Qëllimi i grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve ishte në përputhje me “qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar”! Propozimi im është siç vijon: “qëllimi i grumbullimit të informacioneve nga ASK do të jetë vlerësimi, përpunimi, analizimi dhe përgatitja e produkteve të gatshme, që do të jenë në përputhje me kompetencat e ASK-së”.

Dispozita e nenit 8 paragrafit 3 nuk është në përputhje me qëllimet dhe kompetencat e ASK-së, të parashikuara në nenin 4. Këtu përmendet mbrojtje sekrete e objekteve dhe personave që sigurohen, mirëpo fjala “kundërzbulim” nuk ekziston në kompetencat e paraqitura në nenin 4, e as cila është përmbajtja e masave të tilla. Ky nocion krijon një zbrazëturë ligjore dhe hapësirë për abuzim.

Neni 11 është në kundërshtim me këtë ligj. Konkretisht, Drejtori i ASK-së i paraqet Kuvendit një raport vjetor, që do të thotë se ai tërthorazi i përgjigjet edhe Kuvendit, mirëpo kjo nuk është theksuar në mënyrë eksplicite.

Te neni 19, paragrafi 2, si pikë e fundit të shtohet pjesa për “mënyrat dhe metodat e punës së Agjencisë”. Për të kryer aktivitetet në kompetencën e saj, Agjencia mund të ndërmarrë masa për të fshehur identitetin e punonjësve dhe personave të tjerë, pronësinë e gjësendeve dhe personave juridikë, si dhe qëllimin e grumbullimit të informacioneve. Nëse nuk parashihen mënyrat dhe metodat, krijohet hapësirë për një keqpërdorim të caktuar dhe duke mos i mbrojtur ato, ka vend për abuzim, sepse ato elemente janë të një interesi shumë të lartë operacional për një shërbim tjetër. Përmes dekonspirimit të tyre, zbulohet i gjithë sistemi i funksionimit të ASK-së. Po ashtu, nëse mënyrat dhe metodat nuk përcaktohen qartë, nuk mund të sigurohet mbrojtja e tyre ligjore dhe sistemi për përcaktimin e përgjegjësisë për zbulimin e vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm nuk mund të aktivizohet.

Paragrafi 4 i nenit 21 duhet të shlyhet, sepse bashkëpunimi me shërbimet e tjera të zbatimit të ligjit realizohet me memorandume bashkëpunimi, ndërsa Prokurori Publik dhe Ministria e Punëve të Brendshme janë shërbimet që sipas Ligjit për Prokurorinë Publike janë të autorizuara të veprojnë në rast të marrjes së informacionit për përgatitje, kryerje ose fshehje të një vepre të kryer që ndiqet penalisht me detyrë zyrtare.

Neni 22 paragrafi 3 parasheh që Agjencia të ketë qasje elektronike në regjistrime, koleksione, regjistra që subjektet mbajnë në përputhje me ligjin, bazuar në një memorandum të dakorduar me udhëheqësin e këtij entiteti. Është parashikuar që marrëveshja të mos lidhet me institucionin dhe personin për nënshkrim të autorizuar prej tij, por me udhëheqësin, kështu që parashtrohet pyetja nëse udhëheqësi NN zëvendësohet, del në pension, vdes ose ngjashëm, a është atëherë kontrata e pavlefshme, siç e përcakton kjo dispozitë, duke pasur parasysh që i referohet udhëheqësit!? Është e nevojshme të korrigjohet dhe të qëndrojë “me institucionin” dhe sipas akteve të brendshme të institucioneve, dihet se kush nënshkruan dhe çfarë lloj marrëveshjesh nënshkruan.

Neni 23 paragrafi 4 është në kundërshtim me Ligjin për informacione të klasifikuara. Informacioni i klasifikuar është informacion që duhet të mbrohet sepse zbulimi i tij mund të shkaktojë dëme sipas shkallës së klasifikimit. Në mënyrë që të klasifikohet, informacioni duhet të shënohet siç duhet në një vend të dukshëm me shkallën e klasifikimit, të njohë prodhuesin, sipas parimit “duhet ta di” të dorëzohet dhe përdoret vetëm nga persona të caktuar, etj. “Njohuritë për zbatimin e masave për grumbullimin sekret të të dhënave” nuk mund të **trajtohen** si informacione të klasifikuara nëse nuk shënohen, nuk krijohen në përputhje me Ligjin për informacione të klasifikuara dhe nëse nuk janë zbatuar procedurat e duhura për krijimin dhe klasifikimin, shpërndarjen, ruajtjen, mbrojtjen dhe përdorimin e tyre. Sipas Ligjit për informacione të klasifikuara, nëse dikush vepron në kundërshtim me këtë dispozitë, nuk mund të mbajë përgjegjësi. Kur kjo është kështu, është e kotë të qëndrojnë një dispozitë e tillë. Propozoj të qëndrojnë shprehja “të trajtohet si sekret zyrtar i llojit më të lartë”.

Neni 27 paraqet dispozitat për bashkëpunimin sekret. Në këtë pjesë (me paragraf të ri 6) të përcaktohet se gjatë realizimit të detyrave, bashkëpunëtori sekret gëzon mbrojtje nga Agjencia, kështu që nëse është i lënduar ose humb jetën, detyrimet për trajtim, kompensim dhe varrosje mbuloen nga Agjencia. Paragrafi 7 të saktësojë që dosja për bashkëpunim me një person shkatërrohet pesë vjet pas përfundimit të bashkëpunimit, me aktin e çregjistrimit. Kjo bëhet me qëllim që të krijohet më shumë mirëbesim ndaj institucionit, për të stimuluar bashkëpunim dhe ndjenjë sigurie gjatë bashkëpunimit, si dhe për të parandaluar lustrim eventual në të ardhmen ose deklasifikim të mëvonshëm të dosjeve të bashkëpunëtorëve (përvojat e kaluara). Kjo do të forcojë edhe integritetin e institucionit. Paragrafi 8 - në situata të dëshmisë urgjente dhe të nevojshme të personit me të cilin është realizuar bashkëpunimi sekret, në situata të jashtëzakonshme, kur nuk ka dëshmitarë të tjerë dhe mundësi për të paraqitur prova, personi i cili ka bashkëpunuar fshehurazi me Agjencinë, fiton statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe hyn në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, që të pamundësohet identifikimi i tij/saj para të pandehurve.

Nenet 29 dhe 30 janë në kundërshtim me Ligjin për procedure penale. Përkatësisht, neni 269 i LPP përcakton se “personat me identitet të fshehur janë anëtarë të policisë gjyqësore ose persona të tretë, të cilët, me miratimin e Prokurorit Publik, kryejnë një hetim nën identitet të fshehur ose të ndryshuar”. Ligji për ASK parasheh që përdorimin e personave me identitet të fshehur ta përcaktojë Drejtori me akt nënligjor. LPP konsiderohet akt më i lartë dhe për këtë arsye duhet të respektohet dispozita e tij për përdorimin e personave me identitet të fshehur. Nëse miratohet nga Drejtori, pa dijeninë dhe urdhrin e Prokurorit Publik, nuk do të jetë e mundur të ushtrohen të drejtat e përgjithshme të personit me identitet të fshehur, lidhur me ndryshimin e dokumenteve personale, përgatitjen e dokumenteve të reja, pjesëmarrjen në transaksione ligjore me identitet të ndryshuar, etj. Urdhri do të duhet të paraqitet pranë institucioneve dhe organeve që do të përgatisin dokumentet dhe kushtet për të vepruar me një identitet të maskuar të personit, e të cilin e di vetëm ASK. E njëjta vlen edhe për masën e blerjes sekrete të gjësëndeve dhe dokumenteve. Përveç për qëllime operationale që kanë për cak orientim dhe eliminim, në të shumtat e rasteve gjësendet dhe dokumentet e blera do të duhet të paraqiten si dëshmi në një fazë të procedurës së hetimit, nëse fillohet një procedurë e tillë. Për shkak të parimit të ligjshmërisë, në këso rastesh është e domosdoshme të ketë një urdhër nga Prokurori Publik ose gjykatësi nga procedura paraprake. Këto nene duhet të harmonizohen me LPP.

Në nenin 32 paragrafin 2 dhe nenin 33 paragrafin 2, sërish shtjellohen metodat dhe mënyrat e fshehta të grumbullimit të informacioneve dhe mënyra e miratimit dhe zbatimit. Për shkak të vërejtjeve të lartpërmendura, në nenin 33 paragrafi 2 është e nevojshme të theksohet që “drejtori mund të japë urdhër vetëm nëse informacionet dhe të dhënat përdoren ekskluzivisht për qëllime operative”. Kur të kryhet mbikëqyrje ose kontroll, do të insistohet të inspektohen faktet në lidhje me arsyeshmërinë e masave të ndërmarra, të konstatohen qëllimet specifike për të cilat është zbatuar masa, rezultatet e marra nga veprimet e zbatuara, me qëllim të përcaktimit të abuzimit të mundshëm për qëllime partiake ose personale. Kjo është e nevojshme për të lënë hapësirë për llogaridhënie, transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe në punë.

Neni 45 paragrafi 1 është kontestuar për shkak të formulimit se “Drejtori mund të aprovojë zbatimin e masave për grumbullimin e fshehtë të të dhënave dhe informacioneve, kur të dhënat dhe informacionet nën kompetencë të Agjencisë me qëllim të arritjes së qëllimit, nuk mund të sigurohen ndryshe ose sigurimi i tyre është shoqëruar me vështirësi joproporcionale”. Kjo dispozitë krijon pasiguri ligjore dhe mundësi abuzimi me pozitën e drejtorit. Konkretisht, askund nuk përmendet niveli i rrezikut ose kërcënimit, për të cilat duhet të propozohen njohuri e prova dhe të cilat do të konsiderohen fakte të mjaftueshme e do të paraqesin bazë dyshimi për një aktivitet të identifikuar brenda kompetencave të ASK-së, me qëllim që të merret një leje për përdorimin e tyre dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të arsyeshme. Nuk ekzistojnë njësi matëse objektive që do të kishin treguar se qëllimi nuk mund të ishte arritur me një masë tjetër. Mungesa e kriterëve të matshme dhe mungesa e insistimit për të provuar pamundësinë e zbatimit të masave të tjera, përveç grumbullimit të fshehtë të informacioneve, krijon konfuzion. Si do të paraqiten mundësitë, kushtet dhe rezultati i supozuar nga zbatimi i masave përveç atyre sekrete!? Ky supozim nuk mund të verifikohet ose krahasohet, kështu që për çdo rast, megjithëse mund të mos jetë e nevojshme, shërbimi do të përdorë masa nga infrastruktura e fshehtë operative, duke justifikuar veprimin e vet të ligjshëm me mbështetje juridike se masat tjera nuk do të siguronin rezultatet e duhura. Një dispozitë kaq e gjerë është një parakusht për keqpërdorime të mundshme.

Neni 46 është në kundërshtim me nenin 256 të Ligjit për procedurë penale. Përkatësisht, neni 46 i Ligjit për ASK përcakton që drejtori të vendosë, përkatësisht të aprovojë zbatimin e masave për grumbullimin e fshehtë të të dhënave dhe informacioneve mbi bazën e një kërkesë justifikuese të paraqitur me shkrim nga një zyrtar i autorizuar i Agjencisë. Në nenin 256 të LPP-së për masat me të njëjtin emërtim dhe përmbajtje, si një organ i autorizuar për të urdhëruar masa të veçanta hetimore parashihet të jetë Prokurori Publik, me atë që: masat nga neni 252 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji me një kërkesë të paraqitur të Prokurorit Publik, i përcakton gjykatësi i procedurës paraprake me një urdhër me shkrim, ndërsa masat e përmendura në nenin 252 paragrafi (1) pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji i përcakton Prokurori Publik, po ashtu me urdhër me shkrim. Masat zbatohen nga Prokurori Publik ose policia gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik. Gjatë ekzekutimit të masës, policia gjyqësore përgatit një raport të cilin ia paraqet Prokurorit Publik me kërkesën e tij/saj. ASK nuk është polici gjyqësore. Ligjvënësi sigurisht që ka dashur të veçojë masat parahetuese nga masat që ASK mund të ndërmarrë me miratimin e Drejtorit, por e ka bërë atë në mënyrë të ngathët, sepse emri i masave dhe përmbajtjes së tyre është identik, ndërsa zbatuesit janë të ndryshëm. Kjo dispozitë duhet të ndryshohet ose duke ndryshuar masat apo duke bërë ndryshime dhe plotësime në LPP.

Neni 50 parasheh që Agjencia mban një bazë të dhënash të personave që janë nën trajtimin operacional të Agjencisë për një periudhë të caktuar kohore. Për personat e punësuar në Agjenci ose në agjencitë e zbatimit të ligjit, masa e trajtimit operativ mund të jetë e qartë, por për qytetarët nuk është kështu. Ekziston nevoja që ky nocion i veprimit dhe vendosja e personave nën trajtimin operativ të ASK të sqarohet dhe përcaktohet, por edhe të kufizohet qartë. Kjo të jep përshtypjen (ky term për herë të parë përmendet në këtë pjesë) se punonjësit e ASK-së, përmes të ashtuquajturit trajtim operativ, të ndërmarrin veprime që nuk janë të qarta, që mund të rrezikojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ndërsa të cilësohen si trajtim operativ dhe të kenë një bazë ligjore për këtë. Për shkak të ndjeshmërisë së veprimit të ASK-së dhe përvojave nga e kaluara si një “polici politike”, kjo masë duhet të sqarohet.

Në Kapitullin VII të Ligjit për ASK përfshihet një fushëveprim delikat i kontrollit dhe mbikëqyrjes së Agjencisë. Duke pasur parasysh të gjitha ngjarjet që ndoqën DSK-në e shpërndarë (të cekura në pjesën hyrëse) dhe perceptimin për të, si një shërbim abuzimi dhe mosbesimi, në këtë pjesë është e nevojshme të parashikohen, organizohen dhe zbatohen masa që do të rivendosin besimin e qytetarëve në raport me ASK-në dhe do t'i besojnë veprimeve të saj në përputhje me legjislacionin pozitiv, e jo ta shohin si një instrument për pastrim llogarish politike dhe të tjera. Prandaj, në fazën e pranimit të Propozim-ligjit, u theksua nevoja për të formuar disa mekanizma kontrolli për funksionimin e ASK-së në drejtim të monitorimit, regjistrimit, konstatimit dhe eliminimit të operacioneve të paligjshme dhe jotransparente. Gjatë gjithë ekzistencës së DSK-së, mekanizmat e kontrollit, të cilat janë parashikuar në legjislacionin pozitiv, nuk ishin zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk kanë dhënë rezultate, ndërsa po ai shërbim nuk ka dalë kurrë në mënyrë transparente për të raportuar mbi hapat, metodat dhe procedurat që ka ndërmarrë, megjithëse është thirrur për ta bërë këtë tërë kohën, që nga pavarësia e RMV-së. Në këtë drejtim, së pari parashihet vendosja e kontrollit të brendshëm. Ekzistimi i mekanizmave të pavarur, efikas dhe në kohë për të kontrolluar punën e agjencive të zbatimit të ligjit është një kërkesë në përputhje me KEDNJ dhe praktikën e saj gjyqësore, si dhe në përputhje me gjetjet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT). Si në aspekt praktik, ashtu edhe në aspekt heirarkie, mekanizmat e tillë duhet të jenë të pavarur nga ato që janë nën hetim, të hapura për publikun dhe të afta të marrin vendime ligjërish të detyrueshme. Raportet për gjendjen e të drejtave të njeriut në vend, siç janë ato të KPT, OSBE, Amnesti Interneshënëll, Departamentit të Shtetit të SHBA, si dhe raporteve nga Avokati i Popullit dhe organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut që merren me ankesa keqpërdorimi nga agjencitë e zbatimit të ligjit, sugjerojnë fuqishëm se mekanizmat e kontrollit mbi organet e zbatimit të ligjit nuk janë në nivelin adekuat, të nevojshëm për një vend kandidat për anëtarësim në BE. Prandaj, Ligji për ASK parashikon një njësi të veçantë organizative për kontroll të brendshëm. Brenda kompetencave, janë dhënë mundësi të gjera si në fushëveprim ashtu edhe në përmbajtje. Mirëpo, nuk parashihen mënyrat dhe subjektet që mund të parashtrajnë një iniciativë për ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes nga kontrolli i brendshëm. Gjithashtu, është bërë një lëshim në pjesën e dhënies së një mundësie (nuk specifikohet), por edhe autorizimi, udhëheqësit të njësisë së kontrollit të brendshëm, që të jetë në gjendje të thirret dhe t'u japë informacion organeve mbikëqyrëse, sepse kjo njësi duhet të funksionojë në mënyrë të pavarur, transparente dhe me përgjegjësi edhe në rastet e verifikimit dhe marrjes së masave të tjera kundër drejtorit ose zëvendësit të tij. Me kornizën e tashme, përgjigje për disa procedura mund të japë drejtori, por kush do të informojë për abuzimet e tij/saj të mundshme? Sigurisht

që nuk është e përshtatshme dhe funksionale për veprime të tilla të informoni personin që ka qenë subjekt inspektimi. Prandaj, është e nevojshme të sigurohet një mundësi për mbikëqyrje të punës së njësisë së Punëve të Brendshme nga organet e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Gjithashtu është e nevojshme të parashihet që kjo njësi të veprojë në lidhje me ankesat nga personat të cilët, në përputhje me detyrimet e nenit 51 të Ligjit për ASK, janë informuar se kundër tyre janë ndërmarrë disa masa e metoda operative-taktike ose teknike. Në këtë ligj nuk janë parashikuar fare procedurat e ankesave nga qytetarët, kështu që nuk dihet kush do të veprojë lidhur me këto ankesa. Kjo çështje mund të rregullohet me akt nënligjor, por megjithatë duhet të inkorporohet në ligj.

Në mënyrë që të përfshihen të gjitha elementet që duhet të mbulojnë nga kontrolli i brendshëm dhe për të qenë sa më gjithëpërfshirës, propozoj që në nenin 52 paragrafin 1, në vend të numërimit të kompetencave të kontrollit të brendshëm, të qëndrojë: “njësia mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarisë operative dhe politikën e veprimit; efektivitetin e veprimtarisë operative; praktikën administrative dhe realizimin e financave”. Dispozita të këtilla, të cilat mbulojnë plotësisht aktivitetet mbi të cilat mund të ushtrohet kontrolli dhe mbikëqyrja, do të mbulonin të gjithë elementët e funksionimit të ASK-së dhe do të lejonin mundësinë që me një akt nënligjor të precizohen aktivitetet dhe fushëveprimi në kontekst të mjeteve dhe metodave.

Në kuadër të Prokurorisë Themelore Publike është formuar një njësi e re e specializuar, për të ndjekur penalisht krimet e kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve<sup>1</sup>, ku përcaktohet termi person me kompetenca policore. Ky term “nënkupton një oficer policie, **një person të autorizuar për siguri dhe kundërzbulim** me kompetenca policie, pjesëtarë të policisë financiare dhe policisë së pyjeve, persona të autorizuar me ligj të Drejtorisë së Doganave që punojnë në zbulimin e krimit dhe zyrtarë të autorizuar të Ministrisë së Mbrojtjes, që punojnë për të zbuluar dhe hetuar krimet. Ky departament punon në koordinim të drejtpërdrejtë me njësinë organizative për kontroll të brendshëm”. Ligji për ASK nuk përfshin nenin 33 të Ligjit për Prokurori Publike, megjithëse parashikon kompetencën e Prokurorit Publik për personat me autorizime të posaçme policore të punësuar në ASK. Ndryshimet duhet të bëhen sa më shpejt që të mundësohet harmonizim ligjor, por gjithashtu të krijohet një mundësi që njësi e kontrollit të brendshëm të bashkëpunojë drejtpërdrejtë me departamentin përkatës në Prokurorinë Publike.

Sipas Ligjit për ASK, funksionin e kontrollit mbi masat për grumbullimin sekret të të dhënave dhe informacioneve me urdhër gjykatë dhe mbi mënyrën e përdorimit të pajisjeve të posaçme teknike, e kryejnë ata që kanë lejuar masat, si dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë, gjë që mundëson kontroll cilësor. Neni 58, paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit për ASK, përcakton që Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i autorizuar i Agjencisë që të dëgjojë ose ridëgjojë një bisedë që është objekt i masës së ndërmarrë, të inspektojë përmbajtjen e komunikimit të monitoruar, të inspektojë të dhënat në lidhje me komunikimin e monitoruar, të inspektojë regjistrimet e përgatitura me shkrim lidhur me përdorimin e pajisjeve, të inspektojë regjistrimet elektronike që prodhohen automatikisht në pajisjet speciale teknike, si dhe të kontrollojë të dhënat zyrtare që gjenden në Agjenci. Gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që ka dhënë urdhrin, mund të inspektojë regjistrimet elektronike për përdorimin e pajisjeve.

<sup>1</sup> Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Prokurori Publike, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 198/18 nga 31.10.2018



Mund të konkludojmë se kjo zgjidhje është praktike, sepse për këtë lloj kontrolli Prokurori Publik dhe gjykatësi të mund të përdorin edhe shërbimet e ekspertëve teknikë për verifikim, por lind pyetja për mundësinë e manipulimit të regjistrave elektronikë të pajisjeve (modifikimi, fshirja e shkrimeve, shtimi i përbajtjes, etj). Nëse përdorues i pajisjeve është vetëm ASK, kjo hap mundësinë e abuzimit duke manipuluar regjistrimet elektronike. Në kontekst të kësaj, jam i mendimit që AOT, si një agjenci operative dhe teknike, të ketë kompetencë, autorizim ekskluziv dhe të rreptë, për të manipuluar me të dhënat për përdorimin e pajisjeve (si administrator) dhe për kontroll të regjistrimeve, në mënyrë të pavarur dhe me kërkesë të Prokurorit Publik ose gjykatësit. Me këtë do të arrihet një kontroll i shumëfishtë, ndërsa ASK do të jetë në gjendje t'i përdorë pajisjet, por jo të manipulojë me të dhënat e përdorimit. Me një qasje të tillë do të arrihej qëllimi që të kryhet një masë e veçantë hetimore me ndihmën e pajisjeve speciale teknike, të cilat mundësojnë zbatimin e masës pa ndërmjetësimin e AOT dhe operatorëve, por pa mundësi apo me rrezik minimal abuzimi. Kjo nuk është përfshirë në ligjin ekzistues dhe hap mundësinë për keqpërdorim. Situata është e ngjashme me përgjimin e komunikimeve *online*. AOT është hequr padrejtësisht nga sistemi i kontrollit të procesit. Duke pasur parasysh që pothuajse të gjitha komunikimet elektronike kanë tendencë për platformë *online*, ky mund të jetë një problem dhe lëshim serioz, dhe brenda disa viteve mund ta sjellë në dyshim ekzistencën e AOT. **Për këtë duhet të alarmohet në kohë dhe të insistohet për një zgjidhje.**

Kuvendi krijon komitete që kanë aftësi, detyrë dhe kompetencë për të kontrolluar dhe mbikëqyrur punën e shërbimeve të komunitetit të sigurisë dhe zbulimit. *De lege*, është krijuar një sistem i mbikëqyrjes parlamentare përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së Agjencisë Kombëtare të Sigurisë dhe Agjencisë së Zbulimit, dhe Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e masës speciale hetimore të ndjekjes së komunikimeve. Këto komisione asnjëherë nuk funksionuan siç duhet<sup>2</sup>. Komisionet kanë grup çështjesh saktësisht të përcaktuara të cilat duhet t'i rishikojnë dhe përpunojnë, dhe secila veç e veç, të veprojnë sipas rregullores së punës lidhur me parregullsitë e identifikuara. Secili prej tyre miraton akte që përcaktojnë punën dhe mënyrën e realizimit të mekanizmave të kontrollit. Megjithatë, në periudhën që nga pavarësia e vendit tonë e deri më sot, asnjë komision nuk ka ushtruar kompetencat e veta ligjore. Vërejtje të tilla vërehen edhe në "Raportin e Pribes". Konsideroj se në pjesën e mbikëqyrjes parlamentare duhet të konstatohet se korniza e dobët legjislative rreth mbikëqyrjes dhe kontrollit, si dhe shpërndarja e kësaj përbajtjeje në më shumë ligje, në përgjithësi është joproduktive. Ekziston nevoja për të rishikuar, ripërcaktuar dhe unifikuar dispozitat ligjore. Praktika më e mirë në demokracitë evropiane është se kjo çështje duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm për mbikëqyrje parlamentare të sistemit të sigurisë dhe zbulimit.

Vetë ligji në nenin 60 paragrafin 2 parashikon kufizime kur organet mbikëqyrëse nuk mund të kërkojnë dhe nuk mund të marrin informacion. Në nenin 60 paragrafin 2 thuhet: "Anëtarët e organit punues kompetent të Kuvendit për mbikëqyrjen e Agjencisë **nuk mund** të kërkojnë nga Agjencia të dhëna për: ....". Një qëndrim i tillë

<sup>2</sup> Anëtarët e Komisionit nuk kryenin inspektime në DSK, e madje as nuk mbanin evidencë për ndjekjen e komunikimeve. Është i dukshëm fakti se Komisioni nuk kishte njohuritë e duhura teknike për grumbullimin e të dhënave nga pajisjet e DSK apo nga operatorët e telekomunikimit, që të mundej ta krahasojë numrin e përgjimeve me numrin e urdhërave të dhëna nga gjykata, për të detektuar ndonjë keqpërdorim. Komisioni poashtu u pengua që të bëjë inspektim në DSK, sepse nga gjithsej pesë (5) anëtarë, gjithmonë kishte një apo dy anëtarë që nuk kishin certifikatë sigurie për qasje në informacione të klasifikuara, siç janë të dhënat për përgjim, që qartas paraqet konflikt interesash, duke marrë parasysh se certifikatën e jepte vetë DSK. Drejtori i DSK-së nuk ka marrë pjesë në takime të caktuara, ku është dashur të japë përgjigje pyetjeve të anëtarëve të Komisionit.

është shprehimisht antikushtetues dhe si i tillë nuk duhet të qëndrojë në ligj. E drejta kushtetuese e Kuvendit për të mbikëqyrë pushtetin ekzekutiv nuk mund të kufizohet me ligj. Procedurat e mbikëqyrjes mund të rregullohen në varësi të nevojës për mbikëqyrje mbi një segment të veçantë, por në asnjë rast nuk duhet të ndalohej. Pretendimet në nenin 60 për pamundësinë për të ushtruar kontroll dhe mbikëqyrje (mbi identitete, bashkëpunëtorë, palë të treta, informacione të klasifikuara të marra nga institucione të tjera ose përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, etj.), janë me të vërtetë informacione që mbrojnë interesat e përgjithshme të shtetit, me shkallën më të lartë të klasifikimit dhe rëndësisë, por shtrohet pyetja nëse dikush e abuzon atë për qëllime kriminale, politike, ekstremiste apo qëllime të tjera? Kjo pikëpamje bazohet në përvojat e së kaluarës, që u bënë shkak i drejtpërdrejtë për të filluar me reformat në bashkësinë e sigurisë dhe zbulimit të RMV-së. Prandaj propozoj që neni 60 të riformulohet dhe harmonizohet me Kushtetutën. Në teori, mbikëqyrja që i bën Kuvendi pushtetit ekzekutiv është e pakufizuar.<sup>3</sup> Të ndalosh me ligj një kompetencë kushtetuese të Kuvendit është absurde, respektivisht zhvlerësim i Kushtetutës me ligj.

Rekomandime tjera që duhet t'i paraqiten përbërjes së Kuvendit të ri janë: menjëherë pas krijimit të Kuvendit, të përcaktohen komisionet e përmendura parlamentare të kontrollit, të mbledhen menjëherë (për të përcaktuar metodologjinë e punës konform rregullores) dhe të takohen rregullisht në mënyrë që të ketë përgjegjshmëri parlamentare dhe të ushtrohet një kontroll efektiv dhe efikas. Në këtë kuptim është e nevojshme që të bëhet përcaktimi i detyrave dhe veprimit. Nevojat më urgjente këtu janë, siç vijon:

- të dorëzohen kërkesat dhe të merren certifikatat për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara;
- të punohet gjatë gjithë kohës në realizimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme;
- të përcaktohen veprimet në situata ad hoc, në bazë të iniciativave nga organe ose subjekte për arsye të ndryshme dyshimi në ligjshmërinë e veprimit të ASK-së;
- të krijohen mundësi për raportimin e punës së paligjshme në ASK, duke ua mundësuar qytetarëve të dorëzojnë parashtresa në Komision, ndërsa komisioni përmes njësisë së kontrollit të brendshëm të urdhërojë mbikëqyrje dhe përgjigje lidhur me kërkesën e njëjtë, dhe të kërkojë sqarim të plotë në rast abuzimi;
- të krijohen mundësi për punësimin e ekspertëve, akademikëve; të organizohen trajnime dhe këshillime të ekspertëve për mënyrën e kanalizimit të veprimeve dhe punës juridike, si dhe për shqyrtim të përmbajtjes së mbikëqyrjes; të krijohen mundësi ligjore për kontakt mes komisionit mbikëqyrës me punonjësit e ASK-së për sqarim të menjëhershëm të veprimitarive të paligjshme që janë raportuar;
- të ketë transparencë nga Komisioni Mbikëqyrës dhe në faqen e

<sup>3</sup> Si referencë krahasuese me Kroacinë dhe Slloveninë, nuk ekziston informacion apo e dhënë në të cilën komisioni parlamentar nuk mund të ketë qasje, por për këtë duhet të ketë arsye, interes publik dhe qasja në të është e përcaktuar me procedurë strikte.

internetit të komisionit të publikohen raporte speciale, pa zbuluar të dhëna konfidenciale;

- të krijohen mundësi për intervistim dhe dhënie mendimi lidhur me propozime për emërim të Drejtorit të ASK-së, me qëllim të zgjedhjes së një personi të përshtatshëm me kualifikime më të favorshme, të punohet në ngritjen e besimit të qytetarëve në ASK dhe të shmanget partizimi dhe politizimi i zgjedhjes së drejtorit;
- të miratohet procedurë veprimi e organit mbikëqyrës për vërejtje ose abuzime të funksionit zyrtar të drejtorit dhe dhënien e propozimit për shkarkim të tij/saj.

Konform ligjit, mbikëqyrje mbi punën e ASK-së mund të ushtrojë edhe Avokati i Popullit. Pozicioni i Avokatit të Popullit si një organ i pavarur, i mundëson atij/asaj që në mënyrë të pavarur të detektojë dhe vlerësojë lëshimet dhe veprimet e paligjshme të organeve shtetërore. Ai/ajo mund të fillojë procedurë me vetiniciativë dhe në bazë të ankesave të parashtruara. Vendimet e Avokatit të Popullit nuk janë juridikisht të detyrueshme (megjithatë, ai/ajo ka disa autorizime hetimore siç janë: të kërkojë shpjegime, informacione ose prova, të hyjë në ambiente zyrtare dhe të thërrasë për intervistë persona të zgjedhur ose të emëruar apo ndonjë zyrtar). Sipas strukturës, ai/ajo mbështetet në vullnetin e udhëheqësve nëpër institucione, që ata të zbatojnë rekomandimet e tij/saj dhe janë të detyruar që ta informojnë nëse nuk e bëjnë këtë. Nëse udhëheqësit nuk veprojnë, pavarësisht nëse e kanë njoftuar atë apo jo, ai/ajo mund të fillojë procedurë disiplinore ndaj një zyrtari ose t'i paraqesë një kërkesë Prokurorit Publik kompetent, për të filluar një procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë penale. Mirëpo, deri më tani puna e Avokatit të Popullit në funksion të monitorimit dhe kontrollit të ASK, më parë DSK, nuk ka treguar rezultate të kënaqshme. Fitohej përshtypja se “marrëdhëniet e politizuara shoqërore” ndikojnë në punën e Avokatit të Popullit, ndërsa “arroganca” e udhëheqësve të shërbimit duke se pengonte punën e Avokatit të Popullit në këtë drejtim. Vërehej qartë se interesat politike u vendosën mbi realizimin e politikës së sigurisë së shtetit.

Është e nevojshme që për raste të caktuara të krijohen mundësi ligjore për një mbikëqyrje më subtile nga ana e Avokatit të Popullit, siç janë ankesat që i paraqiten atij/asaj në lidhje me punën e ASK-së. Në këtë kontekst, është e nevojshme të krijohet një mundësi ligjore që Avokati i Popullit të jetë në gjendje të ushtrojë mbikëqyrje të drejtpërdrejtë, përmes inspektimit të drejtpërdrejtë të dokumenteve të caktuara, të cilat ASK do të vendosë t'i ofrojë në dispozicion, duke i dhënë një iniciativë njësisë së kontrollit të brendshëm për të kontrolluar dhe dorëzuar informacione në lidhje me një rast të veçantë, e nëse është e nevojshme, edhe duke i lejuar të realizojë bisedë me udhëheqësit në ASK për raste të ndonjë keqpërdorimi serioz.

Organ Mbikëqyrës i ASK-së është Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e krijuar në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.<sup>4</sup> Në nenin 59 të Ligjit për ASK thuhet se, ndër të tjera, organ mbikëqyrës është edhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila kohët e fundit është riemëruar në Agjenci për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Prandaj, është më praktike në Ligjin për ASK të mos përmenden organe dhe trupa shtetërore (për shkak të miratimit të shpejtë dhe ndryshimit të projekteve juridike), por të

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 42 nga 16.02.2020

specifikohen ligjet sipas të cilave ata kanë të drejtë dhe detyrim të mbikëqyrin. Mbrojtja e të dhënave personale në shërbimet e zbatimit të ligjit ka një rëndësi të veçantë dhe kërkon vëmendje të posaçme gjatë marrjes dhe përpunimit, kujdes për të drejtat e subjektit të të dhënave personale, për pozicionin e kontrolluesit dhe përpunuesit, për transferimin e të dhënave personale në vendet e tjera, për operacionet speciale të përpunimit të të dhënave personale, për mjetet juridike dhe përgjegjësinë gjatë përpunimit të të dhënave personale, mbikëqyrje ndaj mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe kujdes për kundërvajtjet dhe procedimet kundërvajtës në këtë fushë. Qëllimi i ASK-së është të grumbullojë, të përpunojë, të analizojë, të vlerësojë, të shkëmbejë, të ruajë dhe të mbrojë të dhëna dhe informacione, në mënyrë që të zbulojë dhe të parandalojë aktivitete që kanë të bëjnë me kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë kombëtare të vendit nga kategori të caktuara të personave. Në pajtim me qëllimin dhe kompetencat, është e një rëndësie të veçantë të zbatohen plotësisht dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sepse në të kundërtën mund të ndodhin dëme të pariparueshme për integritetin personal të personave që i nënshtrohen trajtimit të ASK-së dhe të cilëve ajo ua monitoron sjelljet, veprimet ose ndaj të cilëve ndërmer masa dhe veprimtari speciale operative. Prandaj, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka mundësi të kryejë funksionin e kontrollit. Auditimi mund të jetë i rregullt, i jashtëzakonshëm ose kontrollues dhe duhet të jetë gjithëpërfshirës, i qëndrueshëm dhe i qëllimshëm, me vetiniciativë ose në bazë të një parashtrese, ankese ose kërkesë të një organi ose personi që mendon se një e drejtë e caktuar sipas këtij ligji i është shkelur. Është detyrim i ASK-së që të mundësojë plotësisht realizimin e auditimit pa penguar ose fshehur, ndryshuar ose pamundësuar shqyrtimin e të dhënave të caktuara personale dhe përdorimin e tyre.

Organ tjetër mbikëqyrës në përputhje me Ligjin për informacione të klasifikuara<sup>5</sup> është Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuara. Drejtoria, përmes inspektorëve për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, mund të kryejë një mbikëqyrje të rregullt, të jashtëzakonshme ose mbikëqyrje kontrolli. Në organet dhe institucionet që merren me informacione të klasifikuara, është e nevojshme të caktohet një oficer ose më shumë të tillë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, i cili/e cila do të jetë përgjegjës/e për trajtimin e vazhdueshëm dhe të ligjshëm të informacioneve të klasifikuara. Për shkak të natyrës së punës, ASK, në përputhje me parimin “duhet ta dijë”, merret me informacione të klasifikuara dhe është e nevojshme të caktojë më shumë se një oficer për sigurinë e informacioneve të klasifikuara. ASK është gjithashtu përgjegjëse për të mundësuar sigurinë fizike, administrative, industriale, sigurinë e sistemeve informative dhe të komunikimit, si dhe sigurinë e personave që përdorin informacione të klasifikuara. Në kushte dhe procedura të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi veprime të caktuara të ASK nga një organ mbikëqyrës ose kontrolli, ASK duhet të përcaktojë, kontrollojë, tregojë dhe pamundësojë aksesin një personi i cili nuk është i autorizuar të punojë me informacione të klasifikuara. Por, nga ana tjetër, me detyrim, nëse anëtar i organit mbikëqyrës ose kontrollit kërkon qasje dhe përmbush kriteret ligjore, atij personi duhet t'i mundësohet akses në trajtimin e informacioneve të klasifikuara.

Enti Shtetëror i Revizionit, me vetiniciativë ose në bazë të një parashtrese, ka mundësinë dhe detyrimin të kontrollojë aspektin financiar dhe ligjor të mjeteve me të cilat punon ASK. Në atë kontekst, auditorët nga Enti Shtetëror i Revizionit kanë të drejtë dhe detyrim të kryejnë një kontroll, dhe është e nevojshme që të kenë qasje në të gjithë dokumentacionin dhe personat që lidhen me operacionet

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 275 nga 27.12.2019

financiare dhe kornizën ligjore në bazë të së cilës funksionon AKS. Raporti i auditimit i paraqitet personit përgjegjës, në këtë rast Drejtorit të AKS-së dhe organeve të mbikëqyrjes dhe kontrollit, si dhe publikohet në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Revizionit. Me dispozitë të këtillë ligjore arrihet transparencë në operacionet financiare dhe ligjore të AKS-së. Sa i përket operacioneve financiare, Ligji për AKS, nuk përcakton askund ekzistimin e fondeve speciale për punën e Agjencisë, të ashtuquajturat “arka speciale”, të cilat zakonisht janë të dedikuara për realizimin e bashkëpunimit sekret. Një mossaktësim i tillë në ligj mund të shkaktojë probleme, sidomos gjatë kontrollit nga auditorët, sepse ata do të duhet të konstatojnë se nuk ekziston asnjë mundësi ligjore që të ketë një “arkë” të tillë. Mjetet e tilla sigurisht që nuk mund të kontrollohen nga auditorët në detaje, por kontestues është evidentimi i tyre në një zë të veçantë kontabiliteti. Në rastin e DSK-së, ekzistimi i një “arke” të tillë rrjedhimisht ngërthente një diskreditim shtesë për të, veçanërisht pas ndërgjegjësimit publik për abuzime të caktuara të fondeve të tilla, jashtë qëllimit për të cilin ato ekzistojnë<sup>6</sup>. Propozoj ndryshime dhe plotësim me një nen të veçantë që ASK-së t’i alokohen mjete për qëllime të veçanta.

Me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve<sup>7</sup> (neni 47) në vitin 2018, u themelua edhe Këshilli për Mbikëqyrjen Civile, si një organ i ri joshtetëror mbikëqyrës, që mbikëqyr masat e zbatuara nga organet e autorizuara dhe AOT, por pa mundësi për t’i mbikëqyrur edhe operatorët. Këshilli i paraqet Kuvendit të RMV-së një raport vjetor për punën e tij. Nismat për veprim janë me vetiniciativë ose në bazë të një ankese të paraqitur nga ndonjë qytetar. Këshilli vepron në bazë të një kërkesë të qytetarëve dhe personave juridikë lidhur me veprime të parregullta të vërejtura ose parregullsi në zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve, veçanërisht në rastet kur ka shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara me kushtetutë. Në lidhje me parregullsitë e konstatuara, Këshilli informon Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje mbi zbatimin e masave të ndjekjes së komunikimeve, prokurorin publik përkatës dhe Avokatin e Popullit. Këshilli mbledhet në seanca që mbahen sipas nevojës. Këshilli realizon mbikëqyrjen me njoftim paraprak, përveç kur natyra e ankesës kërkon reagim urgjent. Ai mund të kërkojë nga udhëheqësit e organeve të autorizuara, AOT dhe operatorët, informacione dhe të dhëna të nevojshme për përcaktimin e arsyeshmërisë së pretendimeve në ankesë. Nga mbikëqyrja e kryer, Këshilli vetëm mund të konstatojë se a është kryer abuzim, por jo edhe të tregojë nëse numri telefonik i ankimuesit është gjurmuar apo jo. Në thelb, Këshilli nuk është një organ mbikëqyrës i drejtpërdrejtë mbi punën e ASK-së. Ai u themelua në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve dhe kompetencat e tij janë të kufizuara vetëm në konstatimin e abuzimit, e jo për të mbikëqyrur masat dhe veprimet e ndërmarra operative apo të konstatojë tejkalim kompetencash, abuzim ose funksionim jo të ndërgjegjshëm. Një mision i tillë i Këshillit nuk i plotëson pritjet për një mbikëqyrje të paanshme, cilësore dhe të pavarur nga ndikimi politik. Arsyet janë të shumta. Do të prek

<sup>6</sup> Sot Prokurori Publik në detyrë i Prokurorisë Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, dha urdhër për ngritjen e një procedure hetimi kundër katër personave, shtetas të Maqedonisë. Personat dyshohen se si të punësuar në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim pranë MPB, kanë keqpërdorur funksionin zyrtar dhe kompetencat e tyre, duke dëmtuar kështu Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për 50.670.000,00 denarë. Konkretisht, në periudhën prej muajit janar 2007 deri në muajin 2017, të dyshuarit si zyrtarë të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, duke mos kryer detyrat e tyre zyrtare, kanë vepruar në kundërshtim me “Udhëzimin për përdorim të mjeteve të DSK për qëllime të veçanta”. Në këtë periudhë kohore, të dyshuarit, në 172 raste kanë tërhequr mjete financiare, për të cilat kanë parashtruar kërkesa dhe kanë paraqitur vërtetime për shumat që kanë marrë. Në fund të vitit, pa miratim nga drejtori i Drejtorisë dhe pa procesverbal, kanë asgjësuar regjistrat për pagesë – “Librat Kryesore për Evidencë”, duke mos lënë kopje të pasqyrave financiare, raporteve dhe Librit Kryesor për Evidencë.

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71 nga 19.04.2018

disa prej tyre. Së pari, korniza ligjore nuk lejon që Këshilli të ketë kompetenca më të mëdha përveç se të konstatojë keqpërdorime, me vetiniciativë ose në bazë të një parashtrere nga një person. Ky pozicion është vetëm një realizim deklarativ i përpjekjeve për funksionim transparent të shërbimeve të zbatimit të ligjit. Së dyti, përbërja e Këshillit përshkruhet në ligj dhe siç ndodh zakonisht, kufizohen profili i personave që mund të jenë anëtarë varësisht nga kualifikimet që kanë (përfshirë avokatët, të diplomuarit në telekomunikacion dhe informaticientët), por përfshihen ata që kanë përfunduar studimet e sigurisë, doganën, administratën publike, etj. Përvoja tregon se këshillat qytetare janë organe të përbëra nga persona me profesione të ndryshme, duke mos potencuar dukshëm aspektin e arsimit paraparak. Momenti kryesor është që ata të jenë të singertë, jopartiakë, të kenë vullnet, qëllim dhe mundësi për angazhim shtesë për punë transparente. Edhe pse vetë ligji parashikon shpallje publike për kandidimin e personave, në rrethanat aktuale u informuan vetëm një numër i vogël i personave, dhe atë me vendimmarrje indirekte partiake. Shpallja ishte me afat të shkurtër dhe u botua në mënyrë jotransparente. Nëse shikoni përbërjen, do të shihni dobësi dhe lëshime të tjera nga ajo ç'parasheh ligji. Në përgjithësi, vëmendje duhet t'i kushtohet përvojës, njohurive, aftësive dhe diametrit të interesit të çdo personi që aspiron të jetë pjesë e këshillit. Nëse ata përfshihen vetëm që këshilli të funksionojë sa për sy e faqe, atëherë në mënyrë të panevojshme vihen në dispozicion aq shumë resurse. Nga ana tjetër, vetë këshilli gjendet në një situatë që pret gjatë kohë për të marrë zyra pune, për të filluar me ndonjë aktivitet, për të pasur mundësinë të konsultohet me ekspertë (ekspertët mund të jenë anëtarë të këshillit, nëse bëhet zgjedhja e duhur; vlen e njëjta që theksova për konkursin), presin gjatë për të marrë një certifikatë për të pasur qasje në informacione të klasifikuara me shkallë sigurie "sekret shtetëror", nuk kanë buxhet të caktuar dhe ndikohen nga partitë që i informuan lidhur me konkursin për anëtarë këshilli. Të gjitha këto janë disa nga problemet për shkak të të cilave pothuajse nuk ka raporte për punën e këtij organi. Misioni i tij është të informojë publikun përmes raporteve, vrojtimeve dhe përmbledhjeve periodike lidhur me funksionimin juridik të ASK-së (në këtë rast) dhe të veprojë në drejtim të rivendosjes së besimit në institucionet e sistemit. Ky organ duhet të karakterizohet me rol proaktiv, e jo duke pritur që një qytetar të raportojë një rast, në mënyrë që ato të aktivizohen. Për të përmirësuar punën e këtij organi, konsideroj se duhet ndryshuar misionin e këshillit, që të jetë në gjendje të veprojë jo vetëm për abuzime të masës së përgjimeve të paligjshme, por edhe të mbikëqyrë mbledhjen e meta-datave, mënyrën dhe përdorimin legal të pajisjeve speciale teknike nga neni 26 i Ligjit për ASK; të mbikëqyrë ligjshmërinë e zbatimit të masave për grumbullimin e fshehtë të të dhënave dhe informacioneve; të bëhen ndryshime në pjesën e profilit të personave që mund të punësohen, të jenë persona me aftësi, njohuri dhe përvojë paraprake pune në ish-DSK dhe tani ASK, persona me integritet dhe të dëshmuar në mjediset ku ata punojnë dhe jetojnë, persona apartiakë. Për sa i përket fondeve, konsideroj se duhet të parashikohen dhe t'i vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për zbatimin e detyrave, sigurimin e mjediseve për punë, personelin mbështetës dhe resurse tjera<sup>8</sup>; të krijohet një mundësi ligjore për të proceduar çështje, e jo vetëm për të informuar autoritete të caktuara; të jenë të detyruar për të informuar publikun në kohë për funksionimin juridik të ASK; të vendoset një bashkëpunim i ngushtë me organet e tjera kontrolluese dhe mbikëqyrëse, me qëllim të veprimit të përbashkët.

<sup>8</sup> Më 14.06.2020, sipas informacioneve në media, Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit për Mbikëqyrje Qytetare kanë deponuar dorëheqjet e tyre për shkak të dobësive të lartpërmendura.

Jo më pak të rëndësishme janë format e mbikëqyrjes nga mediat, organizatat joqeveritare, individët e interesuar ose të prekur nga puna e ASK-së. Ligji nuk përfshin këto forma të mbikëqyrjes, por parashikon vetëm “organe tjera për forma të ndryshme të mbikëqyrjes”. Organizatat joqeveritare janë një faktor i rëndësishëm në kontekstin e përgjithshëm shoqëror, dhe veçanërisht për ushtrimin e mbikëqyrjes bazuar në hulumtimet dhe perceptimet e tyre, bazuar në raportimet nga qytetarët, të cilët i kontaktojnë ata, si dhe duke u bazuar në informacione nga organizata simotra nga vendi dhe jashtë. Mbikëqyrja e organizatave joqeveritare duhet të stimulohet dhe përmes personave të caktuar për komunikim me publikun, duhet të inicohet bashkëpunim më specifik me ASK-në. Për të siguruar informacione në kohë, objektive dhe të paanshme për ASK në fushën e transparencës në punë, ata persona duhet të bashkëpunojnë edhe me mediat që duhet të informojnë për punën e ASK-së. Duhet të merret parasysh fakti që DSK ishte e mbyllur për mediat dhe pikërisht për shkak të mungesës së informimit të opinionit publik, kulminoi mosbesimi ndaj këtij shërbimi dhe u inicua formimi i ASK-së. Plasimi i informacioneve të rrejshme dhe atyre me një dozë të vogël vërtetësie, çoi në shpërbërjen e DSK-së dhe megjithëse pritëm një ndryshim, formim dhe ngritje më cilësore të një shërbimi të ri me parime, masa dhe autorizime të reja, sërish vërejmë se ASK në këtë periudhë tregoi se ende funksionon me parimet e vjetra, vetëm me ndryshime të caktuara kozmetike. Prandaj, është e pritshme që Drejtori i ASK-së, në kuadër të ingerencave që ka, me akt nënligjor të rregullojë transparencën dhe bashkëpunimin e ASK-së me mediat dhe organizatat joqeveritare, dhe madje të krijojë mundësi për memorandume bashkëpunimi me ta për çështje të caktuara me interes të përbashkët.

Dispozitat në vazhdim parashohin bashkëpunim ndërkombëtar. Bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të realizohet mbi parimet e reciprocitetit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Lufta kundër terrorizmit, formave të ndryshme të krimit të organizuar, spiunazhit dhe formave të tjera të krimit, duhet të realizohen përmes informimit të ndërsjellë, ndihmës, trajnimit, kryerjes së detyrave me ekipe të përbashkëta të hetimit, si dhe krijimit të sigurisë për persona dhe objekte në baza bilaterale ose multilaterale. Të gjitha këto duhet të parashikohen me ligj dhe duhet të inicohet zbatimi i tyre. Elementi më i rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar është krijimi, vendosja dhe ruajtja e besimit ndërmjet shërbimeve ose komuniteteve të sigurisë dhe zbulimit.

Kohët e fundit, praktika tregon se kur përcaktohen projektet juridike, në pjesën e kornizës ligjore parashikohen dispozita që nuk janë pjesë e sferës materiale, por e asaj financiare në raport me të punësuarit. Prandaj, konsideroj se inkorporimi në ligj i pikëve për të punësuarit, paraqet një barrë për ligjin. Kjo bëhet me aktin për sistematizimin e vendeve të punës dhe në bazë të angazhimit dhe peshës së përgjegjësive të punës, për secilin pozicion përcaktohen pikët dhe beneficionet.

Punësimet, puna, avancimi dhe ekzekutimi i detyrave zyrtare janë paraparë të realizohen në përputhje me këtë ligj ose me aktet e përgjithshme për punësim në administratë. Si vërejtje e përgjithshme është mungesa e dispozitave për ndërtimin e karrierës dhe kriteret për avancimin, ndërtimin dhe ruajtjen e integritetit të të punësuarve, si dhe diskrecioni i gjerë i Drejtorit për të punësuar pa shpallur një konkurs publik. Dispozitat e tilla, në kushtet e tanishme të ushtrimit të pushtetit në RMV, janë një rast dhe një shkak për keqpërdorime, si dhe një mundësi për të mbushur shërbimin me staf partiak. Ligji parashikon një test integriteti dhe teste poligrafike, mirëpo që nga formimi i ASK-së e deri më tani kjo nuk është realizuar.

Në këtë drejtim, duhet të fuqizohen kontrollet dhe instrumentet mbikëqyrëse, si dhe duhet të konstatohen arsyet e moszbatimit të procedurës së përcaktuar me ligj dhe në kuadër të kësaj, të shqyrtohet abuzimi i mundshëm nga Drejtori. Propozoj ndryshime në këtë pjesë, duke kufizuar ose hequr të drejtën e Drejtorit për të punësuar pa kritere të qarta dhe pa shpallje publike.

Në këtë kontekst, neni 187 parashikon marrjen në punë të punëtorëve nga ish-DSK. Komisioni përzgjedhës, i kryesuar nga Drejtori, bëri një përzgjedhje dhe përdori kontrollet e sigurisë si mekanizëm mbrojtës për skualifikimin e “personave të papërshtatshëm”. Shumë ish-punonjës u shpallën të papranueshëm për çështje sigurie, me kontrolle të shkallës së tretë, të kryera në bazë të Ligjit për informacione të klasifikuara, ndërsa ndaj të tjerëve që u transferuan ose punësuan, u zbatua kontroll i nivelit të dytë, vetëm e vetëm për të vërtetuar “përshtatshmërinë” e tyre. Kontroll të nivelit më të ulët nuk duhet të ketë. Më shumë se 100 ish-anëtarë të DSK-së për risistematizim të mundshëm në MPB mbetën pezull për shkak të kontrolleve të sigurisë, kryesisht të punësuar me përvojë dhe stazh shumëvjeçar. Në këtë mënyrë, që në fillim u dobësua kapaciteti i ASK-së, duke marrë parasysh që një numër i madh i tyre u pensionuan, e disa vetë braktisën punën. Situata aktuale duhet të monitorohet në mënyrë më aktive sepse për një kohë të gjatë organet mbikëqyrëse të Kuvendit nuk funksionojnë<sup>9</sup>, organet e tjera mbikëqyrëse po ashtu presin zgjedhjet, kështu që nuk ka asnjë vlerësim të punës së ASK-së nga organet mbikëqyrëse. Pas zgjedhjeve, në varësi të rezultateve, praktika jonë tregon se do të ketë punësime masive në vendet e lira të punës, kryesisht duke përdorur të drejtën diskrete të Drejtorit. Organet e kontrollit dhe mbikëqyrjes duhet të trajnohen dhe përgatiten, duke u dhënë prioritet ndjekjes së indikacioneve të këtilla, që janë shumë të zakonshme në vendin tonë.

## **Ligji për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit të RMV**

Ligji për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>10</sup> u miratua si rezultat i përgjigjes ndaj vërejtjeve të dhëna për reformat e nevojshme në sferën e sigurisë dhe zbulimit. Njësoj si në rastin me ASK-në, qëllimi ishte që t’i jepet fund abuzimeve me përgjime të paligjshme, që ndodhën gjatë funksionimit të DSK-së. Ligji për koordinimin e bashkësisë së sigurisë dhe zbulimit parashikon krijimin e mundësive për monitorimin dhe koordinimin e tre shërbimeve që punojnë në planin e grumbullimit, vlerësimit, vlerësimit, përzgjedhjes, analizës dhe veprimit në përputhje me misionin e identifikimit, parandalimit dhe pamundësimin të shfaqjes së rreziqeve dhe kërcënimeve për sigurinë kombëtare të RMV-së.

Në këtë ligj, kontestues është roli i Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit të Qeverisë, që janë anëtarë të këtij organi dhe kryesojnë atë. Nëse vërejtja kryesore për nevojën për reforma të DSK-së ishte perceptimi se ky shërbim përdoret për realizim të interesave partiake dhe personale të një grupi të vogël drejtuesish të kryesuar nga Drejtori<sup>11</sup>, atëherë pse gjithë kjo fuqi e madhe të përqendrohet përsëri në duart e një personi (të Kryeministrit)? I gjithë teksti i ligjit është në funksion të legjitimitetit të këtij pushteti, grumbullim të informacioneve më delikate në atë organ, dirigjim i shërbimeve, koordinim të funksionimit të tyre, edhe pse ato kanë hierarki,

<sup>9</sup> Kuvendi u shpërnda më 17.02.2020

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 108 nga 28.05.2019

<sup>11</sup> Në lidhje farefisnore me Kryeministrin e RM



kompetenca dhe metodologji të ndryshme të punës. Qëllimi do të kuptohet kur do të shqyrtohen elementet ligjore për pozicionin e secilit shërbim, që synon të jetë pjesë e organit koordinues përmes ministrit apo drejtorit/udhëheqësit. Në fakt, ky ligj ndërhyr në Ligjin për Agjencinë e Zbulimit. Neni 4 i Ligjit për Agjencinë e Zbulimit<sup>12</sup> parasheh që për punën e tij dhe punën e Agjencisë, Drejtori t'i përgjigjet Presidentit të Republikës së Maqedonisë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të kërkojë përgjegjësi nga Drejtori për punën e Agjencisë.

Nëse Drejtori i përgjigjet Presidentit të Shtetit, atëherë Presidenti është ai që emëron personin e caktuar në këtë pozicion, mirëpo pse ai nuk është pjesë e Këshillit Koordinues, e mbase edhe kryesues i tij? Në kushtet kur Presidenti i shtetit dhe Qeveria janë të së njëjtës proveniencë politike, kjo edhe nuk u pengon aq shumë, por nëse ai raport ndryshon, atëherë mund të ketë bashkëjetesë problematike. Kjo do t'i përkeqësonte shumë marrëdhëniet, sepse anëtarët e Qeverisë të cilët janë anëtarë të Këshillit të Koordinimit janë gjithashtu anëtarë të Këshillit të Sigurimit. Nëse ky kohabitacion nuk funksionon, atëherë anëtarët e Këshillit të Koordinimit do të përdorin propozimet e Këshillit të Sigurimit, por Presidentin do ta njoftojnë në mënyrë selektive. Kjo situatë hipotetike është e mundshme në rrethanat dhe në kontekstin momental politik që mbizotëron në Maqedoninë e Veriut. Edhe në fazën e Propozim-ligjit për Koordinimin pati reagime për përfshirjen e Presidentit të vendit, por kjo nuk është përfshirë në tekstin përfundimtar të votuar.

Ligji për Koordinimin e Bashkësisë të Sigurisë dhe Zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përcakton misionin e organit koordinues dhe në thelb ka të bëjë me përcaktimin e politikave të sigurisë. Politika e sigurisë përcaktohet nga Strategjia për Siguri dhe Strategjia për Mbrojtje, mirëpo organi koordinues nuk ka shumë hapësirë për manovrim të gjerë në ridefinimin e angazhimeve strategjike. Gjithashtu, një nga detyrat e Këshillit të Koordinimit është të rishikojë dhe zbatojë propozimet e Këshillit të Sigurisë të paraqitura në Qeverinë e RMV-së. Këshilli Koordinues përbëhet nga Kryeministri dhe nga tre ministrat që janë anëtarë të Këshillit të Sigurisë. Ata gjithashtu përbëjnë shumicën në Këshillin e Sigurisë, sepse Presidenti i shtetit emëron tre anëtarë të jashtëm. Në mënyrë që Këshilli i Sigurisë të jetë në gjendje të shqyrtojë çështjet e sigurisë, ai duhet të ketë informacione të duhura zbulimi që sinjalizojnë për një rrezik ose kërcënim të mundshëm. Gjatë shqyrtimit të këtyre informacioneve, duke pasur parasysh që nuk ka mundësi të japë urdhra, Këshilli i Sigurisë mund të bëjë propozime, të cilat mund të jenë, por jo domosdoshmërisht, detyruese për Qeverinë dhe institucionet e sferës së sigurisë dhe zbulimit. Nëse rishikohet i njëjti propozim për miratimin e të cilit kanë votuar anëtarët e Këshillit të Sigurisë, e të cilët janë edhe anëtarë të Këshillit Koordinues, atëherë lind pyetja se çfarë do të shqyrtojnë ata?! Deri më tani, edhe pa këtë ligj për koordinim, Këshilli i Sigurisë ka pasur një praktikë t'i paraqesë propozime Qeverisë, ndërsa ajo, brenda kompetencave të saj, ua delegonte detyrat ministrave/drejtuesve të sferës së sigurisë dhe zbulimit. Agjencisë së Zbulimit propozimet me masa konkrete ia paraqiste Presidenti i vendit. Nga e gjithë kjo që u tha më lart, mund të konstatoj se ky këshill koordinues vetëm reflekton dhe dublifikon veprimet e njëjta. Nëse nuk ka zgjidhje tjetër funksionale, atëherë logjika pas formimit të një organi të tillë mund të perceptohet si tendencë që Kryeministri të vendosë nën kontroll të plotë funksionimin e sferës së sigurisë dhe kundërzbulimit (i cili zakonisht është edhe kryetar i partisë që ka fituar më shumë vota në zgjedhje). Në këtë rast, padyshim interesi i vetëm është politizimi i bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit. Nëse dihet se Drejtori i ASK-së emërohet drejtpërdrejt me propozim të Kryeministrit, ndërsa Shërbimit

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e RM, nr. 19/95 nga 06.04.1995

të Inteligjencës Ushtarake nga Ministri i Mbrojtjes, i cili është anëtar i Qeverisë, vetëm Drejtori i Agjencisë së Zbulimit mbetet nën ingerencat e Presidentit. Në kushte të tilla si këto në RMV, kur edhe Presidenti i vendit propozohet nga partia në pushtet, mund të konkludojmë se i gjithë komuniteti i sigurisë dhe zbulimit është nën ingerencat e partisë në pushtet që formon Qeverinë. Gjendja e këtillë dhe vendosja horizontale e vertikale në sistem, shkaktuan shpërbërjen e DSK-së.

Koordinimi realizohet rregullisht, jo më vonë se një herë në tre muaj. Seancat thirren nga Kryeministri. Në ato seanca shqyrtohen raportet dhe propozimet e përgatitura nga Këshilli Koordinues. Këshilli udhëzon anëtarët e Këshillit të Sigurisë dhe Zbulimit që të punojnë lidhur me një rrezik apo kërcënim të mundshëm dhe, duke u bazuar në dispozitat ligjore, kërkon nga ata që të sigurojnë produkte të sferës së zbulimit. Është e palogjikshme që në korniza të fushëveprimit të Zyrës së Këshillit të Koordinimit është paraparë të “bashkojë dhe vlerësojë objektivitetin dhe rëndësinë e raporteve, lajmërimeve, analizave, vlerësimeve dhe informacioneve tjera të paraqitura nga shërbimet e sigurimit dhe zbulimit, të cilat janë të rëndësishme për kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë kombëtare të shtetit”. Ka logjikë në bashkimin e produkteve të analizës së zbulimit nga shërbime të ndryshme, por nuk është logjike të vlerësoni objektivitetin dhe rëndësinë e tyre. Kjo do të thotë që megjithëse çdo informacion zbulimi përgatitet sipas pretendimeve, procedurave dhe metodologjisë së përkrahur në Ligjin për informacione të klasifikuara, përsëri dikush do të shprehte dyshime për objektivitetin dhe rëndësinë e tij, e shumë mirë dihet që produkti i përfunduar është nënshkruar nga titullari më i lartë i shërbimit (drejtori) dhe sigurisht që ky nuk është rezultat i një analize të mosshqyrtimit të më shumë informacioneve! Sigurisht që secili prej shërbimeve do të merrte informacione të ndryshme rreth rreziqeve dhe kërcënimeve të caktuara, në përputhje me praktikën, njohuritë, metodat, mjetet dhe misionin e tyre, por nuk është e mundur që e njëjta ndodhi, ngjarje, procedurë të perceptohet ndryshe deri në atë masë që dikush nga zyra ta vlerësojë objektivitetin dhe rëndësinë. Ndoshta do të ishte më e përshtatshme për të inkorporuar frazën se do “të bashkojë, plotësojë dhe saktësojë...”!

Në nenin 21 të këtij ligji parashihet që Këshilli për Koordinimin e Shërbimeve të Sigurisë dhe Zbulimit detyrohet të paraqesë raporte, brifingje, analiza, vlerësime dhe informacione tjera të rëndësishme për kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë kombëtare të vendit. Këtu mungon një sqarim: “...në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet e identifikuar, e për të cilat Këshilli ka informuar të gjithë anëtarët e komunitetit të sigurisë dhe kundërzbulimit që t’i përqendrojnë veprimet e tyre në atë drejtim”. Nëse kjo nuk është në ligj dhe koordinimi nuk është real, atëherë secili shërbim do të vepronte sipas objektit të tij të interesit, i cili mund të mos i referohet kërcënimeve dhe rreziqeve në fjalë. Prandaj, koordinimi duhet të jetë aktiv, në kohë, tematik dhe gjithëpërfshirës, ndërsa Këshilli do të ketë detyrimin që pas koordinimit të realizuar, të përgatisë një dokument me të cilin do t’i kërkojë secilit prej anëtarëve të Këshillit të vepronte në përputhje me interesin e identifikuar. Udhëzime të tilla do të jenë pjesë e dokumenteve që mund të paraqiten pranë organeve mbikëqyrëse dhe kontrolluese mbi punën e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit, me çka do të tregohet ligjshmëria dhe angazhimi rreth problemit që shqyrtohet.

Në ligjin aktual për koordinim mungon dispozita për transparencë dhe përcaktim të përmbajtjes së koordinimit. Kjo është e nevojshme për t’iu shmangur dyshimeve për keqpërdorime eventuale.

## KONKLUZA DHE REKOMANDIME

Pas analizës së dy ligjeve, përveç atyre tashmë të dhëna, do të shtoja rekomandime shtesë që duhen konsideruar, mundësisht të prezantohen si ndryshime në ligjet e përpunuara, të cilat do të kontribuojnë në zbatimin dhe përmbushjen e duhur të qëllimit të ligjeve, do të shmangeshin dyshimet për keqpërdorim dhe do të synohej për sendërtim të integritet adekuat të shërbimeve. Në përgjithësi është e nevojshme të vazhdohet angazhimi për të punuar ligjërisht, por në një kuptim real dhe jo vetëm në mënyrë deklarative.

Rekomandimi kryesor është që të punohet në drejtim të depolitizimit të shërbimeve të zbatimit të ligjit. Rekomandime shtesë janë:

- të zvogëlohet ndikimi i autoriteteve jashtë shërbimeve;
- të zvogëlohen maksimalisht të drejtat diskrete të udhëheqësve;
- të përcaktohet një drejtim strategjik dhe politikat e duhura të sigurisë;
- të fuqizohen mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes;
- të dorëzohen raporte gjithëpërfshirëse dhe në kohë;
- të punohet për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe të shërbimeve, duke zbatuar masa për mbrojtjen e metodave, mjeteve dhe objektit të interesit;
- kontroll i plotë mbi përdorimin ligjor të pajisjeve teknike, si dhe mënyrën e ruajtjes dhe trajtimit të pajisjeve speciale, që mundësojnë zbatimin e masës pa ndërmjetësimin e AOT dhe operatorëve;
- bashkëpunimi ndërkombëtar të vendoset mbi baza reciproke;
- të sigurohet një shkallë e lartë e mbrojtjes së informacioneve;
- të praktikohen procedura transparente të punësimit dhe qëndrim korrekt ndaj të punësuarve aktualë;
- të përcaktohet një cikël për ndërtim karriere;
- të zbatohen kritere të qarta, të sakta dhe të arritshme për vlerësimin e punës së punonjësve;
- të organizohen trajnime dhe të intensifikohet bashkëpunimi me bashkësinë akademike;
- të harmonizohen procedurat metodologjike për grumbullimin, përpunimin, analizimin, përgatitjen e produkteve të gatshme dhe dorëzimin e tyre brenda afatit tek autoritetet për marrjen e vendimeve cilësore dhe delegimin e menjëhershëm të detyrave lidhur me kërcënimet dhe rreziqet reale dhe aktuale;
- të shmanget keqpërdorimi i informacioneve për qëllime politike;
- asgjësim në kohë dhe i plotë i informacioneve të panevojshme, jashtë përdorimit dhe informacioneve të dyshimta;
- të sigurohet veprim i koordinuar;
- të ketë qasje të koordinuar për ndërtimin e integritetit të shërbimeve, personave të punësuar në to dhe në të gjithë vendin.

## LIGJE TË PËRDORURA

- **Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare** (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 108/19);
- **Ligji për koordinim të komunitetit për siguri dhe kundërzbulim të RMV** (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 108/19);
- **Ligji për ndjekjen e komunikimeve** (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71/18, 108/19);
- **Ligji për Agjencinë e Zbulimit** (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 19/95);
- **Ligji për informacione të klasifikuara** (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 275/19);
- **Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale /** (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 42/20);
- **Ligji për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore** (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 58/00);
- **Ligji për procedurë penale** (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 150/10)

**DCAF** Qendra e Gjenevës  
për Qeverisjen e  
Sektorit të Sigurisë

P.O.Box 1360  
CH-1211 Geneva 1 Switzerland

✉ [info@dcaf.ch](mailto:info@dcaf.ch)

☎ +41 (0) 22 730 9400

---

**[www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)**

---

🐦 [@DCAF\\_Geneva](https://twitter.com/DCAF_Geneva)